



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Udhëzues në praktikën me fëmijë lezbike, gej, biseksualë/e dhe transgjnorë (LGBTI+)



Dhjetor 2019

Ky raport është përgatitur në kuadër të zbatimit nga Qendra Streha, të projektit “ Fuqizimi i Kapaciteteve të Profesionistëve të Mbrojtjes së Fëmijëve për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Dhuna në Shqipëri ”, të mbështetur nga skema e nëngranteve të projektit “Fuqizimi i Shoqërisë Civile për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Dhuna në Shqipëri” zbatuar nga Terre des hommes & ANTTARC dhe financuar nga Bashkimi European në Shqipëri.

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument reflektojnë qëndrimet e autorit dhe profesionistëve të tjerë të cilët kanë kontribuar dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pozicionin e Terre des hommes, [ANTTARC](#), dhe Bashkimi European në Shqipëri.

Pasqyra e lëndës

Hyrje.....	1
Situata aktuale në praktikën profesionale me klientë/e lezbike, gej, biseksualë dhe transgjinorë (LGBTI+).....	3
TERMINOLOGJIA	6
Rëndësia e Njohjes së Terminologjisë.....	8
I. INFORMACION MBI PERSONAT LGBTI+	9
1.1 Sa persona janë LGBTI+?.....	9
1.2 Në cilën moshë e kuptojnë individët se janë LGBTI+?	9
1.3 Si ta kuptoj nëse dikush është LGBTI+?	9
1.4 Dalja hapur	10
1.5 Çfarë e bën një person LGBTI+?.....	10
II. KUADRI LIGJOR.....	11
2.1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë	11
2.2. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD).....	11
2.3. Kodi Penal	11
2.4. Ligji “Për Shërbimet e Kujdesit Shëndetësor”	12
2.5. Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”	13
III. ZHVILLIMI I IDENTITETIT TË FËMIJËVE DHE TË RINJVE LGBTI+	15
3.1. Përkufizimet e lidhura me identitetet transgjinore	19
IV. SFIDAT E FËMIJËVE DHE TË RINJVE LGBTI+.....	20
4.1. Çfarë është Bullizmi?.....	20
Çfarë është bullizmi homofobik?	21
Bullizmi fizik	22
Reagimi ndaj gjuhës homofobike dhe bullizmit në shkolla.....	23
4.2. Dhuna në familje	23
4.3. Përmbledhje e problemeve të shëndetit mendor tek personat LGBTI+.....	29
4.4. Adresimi i sfidave të përmendura nga profesionistët	29
Guidë për një praktikë më të mirë me personat LGBTI+	29
4.5. Studime rastesh dhe çështje për reflektim.....	34

V.	VLERAT, BESIMET STEROTIPET DHE PARAGJYKIMET E PROFESIONISTËVE QË MUND TË NDËRHYJNË NË PUNËN E TYRE ME FËMIJËT LGBT.....	35
VI.	MITE DHE FAKTE	38
VII.	SHËRBIMET PER PERSONAT LGBTI+	41

Hyrje

Të rinjtë lezbike, gej, biseksualë/e dhe trangjinorë (LGBTI+) janë ndër nëngrupet më pak të njohura nga profesionistët të cilët ofrojnë shërbime Ky udhëzues që është bazuar në praktikën profesionale të organizatave LGBTI+ me klientë/e lezbike, gej, biseksualë/e dhe trangjinorë (LGBTI+), dëshiron t'iu ofroj profesionistëve që punojnë në fushë mbrojtjes së fëmijëve, informacion bazik dhe një kuadër referimi në këshillimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve dhe të rinjve LGBTI+. Udhëzuesi është mbështetur në praktikat më të mira në Shqipëri dhe jashtë saj si dhe në përvojën të organizatve të përkushtuara në ofrimin e shërbimeve për personat LGBTI+..

Në vitin 1975, Shoqata Amerikane e Psikologëve (APA) përcaktoi një rezolutë që thoshte se “homoseksualiteti nuk tregon në vetvete dëmtim në gjykim, stabilitet, qëndrueshmëri ose aftësi të përgjithshme sociale apo profesionale” dhe këshillon që “të gjithë profesionistët e shëndetit mendor të kenë si parim udhëheqës heqjen e stigmës së sëmundjes mendore kur bëhet fjalë për punën me personat meorientim homoseksual” (Conger, 1975, p. 633)¹. Në 2009, shoqata pohoi se “tërheqjet romantike, ndjenjat dhe sjelljet mes të njëjtit seks janë normale dhe variacione të seksualitetit njerëzor pavarësisht orientimit seksual (APA, 2009, p. 121)². Në një studim të Garnets, Hancock, Cochran, Goodchilds, dhe Peplau (1991)³, u zbuluan mangësi në cilësinë e kujdesit terapeutik të ofruar ndaj klientë/eve lezbike, gej, biseksualë/e dhe trangjinorë (LGBTI+). Këta autorë dhe të tjerë (p.sh., Fox, 1996; Greene, 1994b; Nystrom, 1997; Pilkington & Cantor, 1996)⁴ sugjeruan se kishte nevojë për trajnim

¹ Conger, J. J. (1975). Proceedings of the American Psychological Association for the year 1974: Minutes of the annual meeting of the Council of Representatives. *American Psychologist*, 30, 620–651. doi:10.1037/h0078455

² American Psychological Association. (2009a). Lesbian, gay, bisexual, and transgender persons and socioeconomic status. Retrieved from <http://www.apa.org/pi/ses/resources/publications/factsheet-lgbt.pdf>

³ Garnets, L., Hancock, K., Cochran, S., Goodchilds, J., & Peplau, L. (1991). Issues in psychotherapy with lesbians and gay men: A survey of psychologists. *American Psychologist*, 46, 964–972. doi:10.1037/0003066X.46.9.964

⁴ Fox, R. (1996). Bisexuality in perspective: A review of theory and research. In B. A. Firestein (Ed.), *Bisexuality: The psychology and politics of an invisible minority* (pp. 3–50). Thousand Oaks, CA: Sage.

- Greene, B. (1994b). Lesbian and gay sexual orientations: Implications for clinical training, practice, and research. In B. Greene & G. Herek (Eds.), *Psychological perspectives on lesbian and gay issues: Vol. I. Lesbian and gay psychology: Theory, research, and clinical applications* (pp. 1–24). Thousand Oaks, CA: Sage.
- Nystrom, N. (1997, February). Mental health experiences of gay men and lesbians. Paper presented at the meeting of the American Association for the Advancement of Science, Houston, TX.
- Pilkington, N., & Cantor, J. (1996). Perceptions of heterosexual bias in professional psychology programs: A survey of graduate students. *Professional Psychology: Research and Practice*, 27, 604–612. doi: 10.1037/0735-7028.27.6.604

dhe arsimim më të mirë në punën me klientë/e LGBTI+. Duke qenë se lëvizja LGBTI+ në Shqipëri ka filluar vetëm në dekadën e fundit, lind nevoja për rritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve dhe pajisjen e tyre me udhëzues praktikë gjatë punës së drejtpërdrejtë me personat LGBTI+.

Çdo profesionist i fushës së mbrojtjes së fëmijëve që punon me klientë/e LGBTI+ duhet të jetë familjar me disa koncepte bazë në punën me personat LGBTI+. Qëllimi kryesor i këtij udhëzuesi është të informojë profesionistët e mbrojtjes së fëmijëve mbi mënyrën sesi mund të mbështesin më mirë fëmijët dhe të rinjtë LGBTI, duke i ndihmuar ata në sfidat e tyre dhe duke ju komunikuar pranim dhe mbështetje .

Udhëzuesi fillon me termat kryesorë, pasohet nga kuadri ligjor, zhvillimi dhe identiteti i fëmijëve dhe adoleshentëve LGBTI+, format kryesore të dhunës dhe abuzimit dhe pasojat e saj tek fëmijët dhe adoleshentët LGBTI+, shpjegon sesi vlerat individuale dhe stereotipet gjinore kulturore mund të ndikojnë punën e profesionistëve me fëmijët dhe të rinjtë LGBTI+ ; identifikon mitet më të shpeshta që lidhen me fëmijët dhe të rinjtë LGBTI+ dhe ndiqet nga rekomandime, të ilustruara nga shembuj të praktikës.

Situata aktuale në praktikën profesionale me klientë/e lezbike, gej, biseksualë dhe transgjinorë (LGBTI+)

Në Shqipëri në kohën e regjimit komunist, aktet ndërmjet personave të të njëjtit seks konsideroheshin si devijim i turpshëm dhe ngatërroheshin me pedofilinë, ndëshkoheshin rëndë nga ligji dhe nga morali, duke çuar në izolim nga shoqëria, mohim nga familja, dhe dhunë⁵. Gjatë periudhës komuniste, personat LGBTI+ ishin të padukshëm, pjesërisht për shkak të armiqësisë së publikut, por edhe për shkak të penalizimit dhe persekutimit të institucionalizuar. Personat LGBTI+, të diskredituar nga shoqëria dhe të ndaluar nga ligji, detyroheshin të takoheshin në mënyrë klandestine, në vende të fshehta, madje shpesh të lidhnin edhe martesat të rreme heteroseksuale. Ata nuk mund t'i kundërviheshin padrejtësive të regjimit edhe ngaqë të drejtat e njeriut ishin shumë të kufizuara në Shqipërinë komuniste.

Pas rrëzimit të regjimit komunist në vitin 1990, Shqipëria hyri në periudhën e tranzicionit drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Vendi hyri në rrugën e reformave rrënjësore ekonomike, politike, sociale dhe kulturore. Liria e lëvizjes dhe migrimi i bëri shqiptarët të njihen me ndikimet kulturore të Perëndimit. Me gjithë këtë hapje më të madhe kulturore, niveli i të kuptuarit dhe toleranca ndaj personave LGBTI ende mbetet e ulët. Kuvendi i Shqipërisë dekriminalizoi marrëdhëniet seksuale konsensuale ndërmjet personave të të njëjtit seks në vitin 1994.

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (sot Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) ka hartuar dy plane veprimi kombëtare për të drejtat e personave LGBT, njëri për vitet 2012-2014⁶ dhe tjetri për periudhën 2016-2020⁷. Plani i parë hapi rrugën drejt bashkëpunimit institucional ndërmjet MMSR, institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organizatave me fokus personat LGBTI. Plani i dytë u iniciua në tetor të vitit

⁵ <https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/web%20version%20SHQIP%20FINAL%20REPORTok.pdf> konsultuar me 9 dhjetor 2019.

⁷ Kombet e Bashkuara (2014e) Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, Universal Periodic Review Albania (Rishikimi Periodik Universal për Shqipërinë), 2014, MEDIA BRIEF, e hënë, 28 prill 2014, gjendet në: <http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/RPU/Pages/Highlights28April2014pm.aspx.34> Ministria e Mirëqënies Sociale, Rinisë dhe Sporteve (2016) Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI në Shqipëri për 2016-2020, gjendet në: <http://www.sociale.gov.al/al/dokumente/strategji>, aksesuar më 10.08.2016

2016, me krijimin e Grupit Kombëtar të Zbatimit dhe Koordinimit (GKZK). Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka filluar trajnimin e mësuesve për çështje të mosdiskriminimit, por nuk ka trajtuar në praktikë diskriminimin e nxënësve LGBTI dhe përfshirjen e të drejtave të tyre në programet mësimore. Ministria e Drejtësisë nuk ka bërë ndryshime në Kodin e Familjes për të lejuar martesat ndërmjet personave të të njëjtit seks ose bashkimet civile dhe qeveria aktuale ka shprehur se nuk është në planet e saj që të bëhet dicka e tilla. Ndërsa MB nuk ka nxjerrë akte nënligjore për njohjen zyrtare të ricaktimit të gjinisë. Nuk ka protokolle për ndërhyrjet kirurgjikale për ricaktimin e gjinisë (KRS).

Ndërkohë, punonjësit në fushën e mbrojtjes së fëmijëve që punojnë me fëmijë dhe të rinj LGBTI+ nuk kanë informacionin e duhur dhe mund të mbartin në mënyrë të pandërgjegjshme stereotipe dhe paragjykime mbi komunitetin si pjesë e kulturës tradicionale dhe homofobe që bëjnë pjesë dhe rritjes në familje ku normat patriarkale janë të forta. Kjo bën që ata të mos mund të adresojnë në mënyrën e duhur sfidat me të cilat fëmijët dhe të rinjtë përballen apo t'i mbrojnë ata nga abuzimi. Fëmijët dhe të rinjtë LGBTI+ që janë asistuar nga Qendra Streha kanë ndarë histori që kanë ndikuar negativisht në jetët e tyre të lidhura me shfaqjen e diskriminimit nga ana e punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve, thyerjes së konfidencialitetit apo mungesës së etikës. Këto jo vetëm ndikojnë që personi të mos marrë shërbimet për të cilat ka nevojë por edhe minon besimin e personave LGBTI+ tek sistemi i mbrojtjes së fëmijëve dhe profesionistët që e përbëjnë këtë sistem.

Studimet dhe përvoja e organizatave të tilla si Aleanca për Mbrojtjen nga Diskriminimi i Personave LGBT dhe Qendrës Streha në Shqipëri kanë treguar se është e nevojshme të rriten kapacitetet e punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve kur ato përballen me raste fëmijësh dhe të rinjsh LGBTI+. Gjatë punës me personat LGBTI+, trajnimeve, vizitave në terren dhe analizës së nevojave në fushën e mbrojtjes së fëmijëve të personave LGBTI+, u identifikua nevoja për të rritur informacionin dhe njohuritë e psikologëve e punonjësve socialë mbi karakteristikat, fazat e zhvillimit, dhunën dhe abuzimin e përdorur nga fëmijë dhe të rinjtë LGBTI+. Duhet të ndërmerren hapa të vërtetë që punonjësit të jenë më tolerantë dhe të hapur, dhe të krijojnë një ambient mbështetës ku fëmijët dhe të rinjtë LGBTI+ që kanë nevojë për informacion, mbështetje apo janë të abuzuar, të mund të ndihen të sigurtë dhe të vetëdijshëm se mund të kenë të gjithë ndihmën e nevojshme nga këta punonjës.

Në këtë kuadër, është hartuar ky udhëzues nga Qendra Streha që përmes hapave të thjeshtë synon t'u ofrojë psikologëve e punonjësve socialë, si dhe gjithë punonjësve në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të identifikuar nevojat e fëmijëve dhe të rinjve LGBTI+ si dhe për të identifikuar viktimat LGBTI+ të dhunës dhe abuzimit dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë sa më efektive këtyre rasteve.

TERMINOLOGJIA

LGBTI: Ky është akronimi për “lezbike, gej, biseksual dhe transgjinator”. Duhet të kemi parasysh që me kalimin e kohës dhe me zhvillimet që shoqëria dhe gjuha pëson, kjo listë akronimesh është pasuruar dhe zgjeruar.

Lezbike: Një grua ose vajzë e cila tërhiqet emocionalisht, fizikisht dhe seksualisht nga një grua tjetër.

Gej: Një mbiemër që ka zëvendësuar gjerësisht fjalën “homoseksual” kur i referohemi meshkujve që janë seksualisht dhe emocionalisht të tërhequr nga meshkuj të tjerë.

Biseksual: Individët që tërhiqen emocionalisht dhe seksualisht nga të dyja sekset. Nuk supozon ose hamendëson jo-monogami. Disa njerëz identifikohen si “bi” në vend të biseksualë.

Transgjinator: Termi transgjinator përdoret si një term ombrellë për personat që e ndjejnë ose e shprehin gjininë e tyre ndryshe nga pritshmëritë e shumicës bazuar në seksin e tyre biologjik. Ky grupim mund të përfshijë personat transeksualë ose ata që vishen ‘ndryshe’.

Transeksual: Ky term përdoret për persona të cilët duan të jetojnë / t’i përkasin një gjinie të ndryshme nga ajo që u është përcaktuar kur lindën. Këta persona mund të kërkojnë ndihmë mjekësore duke marrë hormone ose kryer ndërhyrje kirurgjikale për të jetuar sipas gjinisë me të cilën ata identifikohen. Në të shumtën e rasteve, ndjesia e përkatësisë në gjininë e kundërt nga ajo e regjistruar në lindje përjetohet gjatë të gjithë jetës.

Tranvestit: Ky është një term i papërshtatshëm, i cili konsiderohet ofendues për shumë njerëz. Në të kaluarën, ky term përdorej kryesisht për burra të cilët visheshin dhe silleshin si gra për qëllim të përfitimit emocional ose seksual.

Queer: Është një fjalë që njerëzit e përdorin për të përshkruar identitetin e tyre gjinor i cili nuk konformohet me standartet sociale dhe normat tradicionale të gjinisë. Queer mund të vetëquhen personat gej, lesbike, biseksual, straight etj.

Interseks: Interseksualiteti është një term ombrellë për personat që lindin me ndryshime në karakteristikat gjinore, kromozome dhe/ose hormone, të cilat mund të mos përkrijnë me pritshmërinë shoqërore dhe mjekësore. Më konkretisht, personat interseksualë lindin me karakteristika fizike ose biologjike të gjinisë (si anatomia seksuale, organet riprodhuese, strukturat hormonale dhe/ose strukturat kromozomale) që nuk përputhen me përkufizimet tipike për trupat e meshkujve ose të femrave. Ndonjëherë, kur lind një bebe, ajo lehtësisht mund të identifikohet si interseksuale nga karakteristikat trupore. Ka raste që foshnjat interseksuale kanë organe gjenitale të jashtme që duken qartësisht si organe femërore ose mashkullore, por organet gjenitale të brendshme mund të jenë të ndryshme, të keqformuara ose mund të mungojnë. Ndaj, në disa raste, një trup interseksual mund të zbulohet gjatë fëmijërisë, në pubertet, madje edhe gjatë jetës si i rritur.¹

Heteroseksual: Ky term u referohet personave të cilët tërhiqen emocionalisht, fizikisht dhe seksualisht nga persona të seksit të ndryshëm.

Homoseksualiteti: Homoseksualiteti është tërheqja fizike, emocionale ose seksuale ndaj personave të të njëjtit seks. Duke qenë se ky term është lidhur me shumë stereotipe negative dhe paragjyqime në shoqërinë tonë, termat gej ose lezbike janë më shumë të rekomanduar kur i referohemi personave të cilët tërhiqen nga i njëjti seks.

Homofobi: Ky term i referohet frikës, zemërimit, urrejtjes, mostolerimit dhe mospranimit të personave LGBTI.

Homofobi e brendësuar (interiorizuar): Homofobia e brendësuar dhe shtypja ndodh tek personat homoseksual, lezbike, biseksualë, dhe madje edhe heteroseksualëve, të cilëve i është mësuar se heteroseksualiteti është normë dhe "mënyra e saktë e të qenurit". Personat LGBTI në disa raste përvetësojnë mesazhet negative që pjesa tjetër e shoqërisë projekton ndaj tyre. Disa persona LGBTI vuajnë nga shqetësime mendore, si rezultat i kësaj.

Dalja hapur / Dalja nga dollapi: Procesi i njohjes, ndërgjegjësimit dhe pranimit të orientimit jo-heteroseksual ose identitetit gjinor me veten dhe pastaj ndarja me të tjerët. Fillimisht, shumë të rinj LGBTI, krijojnë barriera emocionale kundrejt të njohurve të tyre, miqve dhe familjarëve duke pretenduar (konkretisht ose nëpërmjet heshtjes) se janë heteroseksualë. Dalja hapur zakonisht ndodh me etapa, dhe është një proces jo linear. Termi i daljes nga dollapi është marrë dhe përkthyer direkt nga gjuha angleze duke qënë se në shqip nuk ekziston një term i tillë.

Seksi biologjik: Seksi biologjik i referohet ndarjes së njerëzve në meshkuj dhe femra bazuar në disa karakteristika biologjike, të tilla si: kromozomet, hormonet, ose organet gjentiale.

Shprehje gjinore - i referohet mënyrave se si shprehet gjinia, zakonisht përmes pamjes, veshjes, manierizmave etj. Shprehja gjinore bazohet te normat kulturore dhe ndryshon në vende dhe kontekste të ndryshme.. Zakonisht është një zgjerim i identitetit gjinor, mënyra që ka dikush për të qenë burrë, ose grua.

Identiteti gjinor: Ky term i referohet përjetimit të brendshëm psikologjik të gjinisë tek një person; gjini e cila mund të përputhet ose jo me seksin e regjistruar pas lindjes. Identiteti gjinor është i ndryshëm nga orientimi seksual.

Rolet gjinore: Rolet gjinore janë seti i roleve dhe sjelljeve të lidhura me të qenit femër ose mashkull nga një shoqëri e caktuar. Rolet gjinore, pra mënyra se si shoqëria pret se duhet të sillen dhe të ndihet një femër dhe një mashkull, janë të ndryshme në kultura të ndryshme por dhe në periudha kohore të ndryshme.

Orientimi seksual: Tërheqje seksuale e natyrshme. Prirja ose aftësia për të zhvilluar marrëdhënie intime emocionale ose seksuale me njerëz që i përkasin të njëjtës gjini, gjinisë së kundërt apo më shumë se një gjinie. Ky term këshillohet të përdoret në vend të "preferencë seksuale" ose terminologjive të tjera jo të përshtatshme.

Parada e Krenarisë shpesh edhe Parada Gej: Event në të cilin komuniteti LGBTII dhe mbështetësit e tyre parakalojnë (shpesh duke ecur në këmbë) për të shprehur krenarinë e tyre të të qenurit gay, lezbike, transgjinorë, biseksualë. Krenaria për të dalë hapur gjatë këtij aktiviteti konsiston në faktin që komunitetit LGBTII i është dashur të luftojë me dekada për njohjen e te drejtave të barabarta si dhe për faktin që mos njohja e tyre si pjesë e barabartë e

shoqërisë e ben këtë komunitet vulnerabël. Këto parakalime shpesh kanë formën e një feste por në mjaft raste ata janë thjesht parakalime apo manifestimeve simbolike për të kërkuar të drejtat themelore të cilat ju mohohen.

Rëndësia e Njohjes së Terminologjisë

Ka dy aspekte të rëndësishme për të pasur parasysh rreth terminologjisë:

1. Gjuha që përdorni ka rëndësi.
2. Gjuha po evoluon në mënyrë të vazhdueshme.

Gjuha që ju përdorni ka rëndësi, sepse të qenit të kujdesshëm dhe përzgjedhja e fjalëve të duhura është një nga mënyrat më të thjeshta për të krijuar një mjedis të sigurtë dhe pranues për personat me të cilët punoni. Brendësimi dhe përdorimi i kujdesshëm (ose disa herë mospërdorimi) i termave më lart ndihmon personat LGBTI+ për të cilët ju kujdeseni për t'ju identifikuar si një person të hapur dhe pranues me të cilin mund të ndajnë ndjenjat e tyre dhe në të cilin mund të mbështeten.

Si për çdo aspekt tjetër, gjuha e kujdesshme dhe e saktë duhet të reflektohet jo vetëm në atë të folur, por dhe në gjuhën që përdoret në mbajtjen e dokumentacionit, ofrimin e këshillave gjatë mbështetjes së një rasti ose diskutimin e tematikave të ndryshme në mënyrë që ajo të jetë gjithëpërfshirëse.

Teksa lexoni termat më lart, kini parasysh që kjo listë nuk është shtruese, duke qenë se gjuha dhe shoqëria në të cilën jetojmë është gjithmonë në evoluim. Nëse gjatë punës suaj ju përballeni me një term të ri, merrni pak kohë për ta kontrolluar ose pyesni kolegët tuaj për domethënien dhe sa e përshtatshme është të përdoret në ndërveprimet me personat LGBTI+.

I. INFORMACION MBI PERSONAT LGBTI+ ⁱⁱ

1.1 Sa persona janë LGBTI+?

Në Shqipëri nuk ka studime ose vlerësime në nivel të popullatës për numrin ose përqindjen e personave që identifikohen si LGBTI+, megjithatë, statistikat nga vende të ndryshme tregojnë se rreth 5-10% e popullatës janë lezbike, gej, biseksualë ose transgjnorë.

1.2 Në cilën moshë e kuptojnë individët se janë LGBTI+?

Shumë persona LGBTI+ raportojnë se kanë qenë të ndërgjegjshëm për orientimin e tyre qysh në vogëli, shumë përpara eksperiencës së tyre të parë seksuale. Të tjerë mund të mos jenë të ndërgjegjshëm rreth orientimit të tyre seksual ose identitetit gjinor deri në moshë të rritur. E rëndësishme është që asnjëherë të mos paragjykojmë se dikush është ‘shumë i vogël’ ose ‘shumë i madh’ për të dalë hapur dhe shprehur orientimin seksual ose identitetin gjinor.

Studimet tregojnë se orientimi seksual në të shumtën e rasteve formësohet gjatë fëmijërisë së hershme. Studimet gjithashtu tregojnë se shumë adoleshentë LGBTI+ e identifikojnë veten si lezbike ose gej rreth moshës 16 vjeç, ndërkohë që ndërgjegjësimi për tërheqjet me seksin e njejte fillon rreth moshës 9-vjeçare për djemtë dhe 10-vjeçare për vajzat.

Ndërgjegjësimi mbi dallimet biologjike mes vajzave dhe djemve ndodh tek fëmijët rreth moshës 3-vjeçare, ndërsa identiteti gjinor – ndjesia e brendshme e të qenit femër ose mashkull – tek personat transgjnorë raportohet si përjetim konflikti përgjatë gjithë fëmijërisë dhe adoleshencës.

1.3 Si ta kuptoj nëse dikush është LGBTI+?

Jo të gjithë personat LGBTI+ vetë-identifikohen si të tillë dhe shpesh kjo ndodh për shkak të frikës që ata kanë nga paragjykimet dhe refuzimi. Në të kundërt, disa individë të cilët perceptohen nga të tjerët si LGBTI+, në fakt nuk janë të tillë. E vetmja mënyrë e sigurt për të ditur nëse dikush është LGBTI+ është nëse ai/ajo ju shprehet se është LGBTI+. Deri atëherë, asnjëherë mos u bazoni në paragjykimet dhe stereotipet rreth personave LGBTI+ për të hamendësuar orientimin seksual ose identitetin gjinor të dikujt.

Megjithatë, nëse gjatë punës suaj ju ndesheni me dikë që keqtrajtohet ose dhunohet për shkak se perceptohet nga të tjerët si LGBTI+, ju duhet të veproni menjëherë, pa qenë e nevojshme të qartësoni nëse personi është ose jo LGBTI+. Në rastin e fëmijëve është e rëndësishme që të ndiqen procedurat në përputhje me VKM Nr. 578 e cila saktëson

procedurat e menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Qëllimi juaj si profesionist është që të tregoheni të hapur dhe pranues për të gjithë femijët, duke dhënë sinjale për ata që janë LGBTI+ se ju jeni një person i sigurt që do t'i ndihmoni në rast diskriminimi ose keqtrajtimi.

1.4 Dalja hapur

Dalja hapur është procesi i ndërgjegjësimit dhe pranimit të identitetit gej (dalja hapur ndaj vetes) dhe shpallja e këtij identiteti (dalja hapur ndaj të tjerëve). Ai është një proces zhvillimor unik për personat LGBTI+. Ndërgjegjësimi mbi identitetin gej, lezbik apo biseksual dhe zhvillimi i tij nuk është një ngjarje e vetme, po një proces, i cili shpesh zgjat gjithë jetën dhe ecën paralel me zhvillimin si person. Dalja hapur ndaj vetes përfshin ngjarje të tilla si ndërgjegjësimi mbi tërheqjen e parë ndaj seksit të njëjtë, puthja e parë me të njëjtin seks, ndjenjat e të qenit 'ndryshe' nga bashkëmoshatarët si fëmijë apo adoleshent, diskutimi me veten (A jam gej/lezbike/ biseksual/biseksuale?), përvoja e parë e një ngjarjeje shoqërore (për shembull, një bar gej, një paradë gej), vetë-etiketimi (Unë jam gej/ lezbike/ biseksual/biseksuale!) dhe shumë ngjarje të tjera në jetën e një personi. Dalja hapur shpesh fillon në moshën e rritur të hershme, por mund të fillojë në çdo moshë apo fazë të jetës.

1.5 Çfarë e bën një person LGBTI+?

Arsyet pse disa persona janë LGBTI+ dhe disa të tjerë jo, nuk janë ende të qarta, por ajo që dihet është se përpjekjet për të ndryshuar orientimin seksual ose identitetin gjinor nuk funksionojnë. Përkundrazi, ndërhyrje të ndryshme psikologjike ose mjekësore (si ato hormonale) në përpjekje për të 'riparuar' orientimin seksual drejt të njëjtit seks janë konsideruar nga organizatat e shëndetit si jorezultative dhe të dëmshme për shëndetin mendor dhe fizik të fëmijës apo te rriturve. Gjithashtu, është e gabuar të mendoni se të gjithë personat LGBTI+ janë të traumatizuar ose dhunuar gjatë fëmijërisë së tyre, ose se identifikimi si LGBTI+ është thjesht një sjellje 'për t'u dukur' ose për të tërhequr vëmendjen. Personat LGBTI+ kanë qenë gjithmonë pjesë e shoqërisë, pavarësisht se njohuritë, konceptet dhe niveli i pranimit të tyre kanë ndryshuar ndër vite.

II. KUADRI LIGJOR

2.1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kushtetuta përcakton të drejta gjithëpërfshirëse për qytetarët (neni 15) dhe garanton barazinë para ligjit, pavarësisht nga, ndër të tjera, edhe gjinia (neni 18). Gjinia mund të interpretohet në një kuptim të gjerë si një term që përfshin edhe identitetin gjinor.

2.2. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD)

Që nga viti 2010, Shqipëria ka miratuar një ligj të përgjithshëm për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD), i cili është përgjithësisht në përputhje me standardede BE-së për barazinë . Ai “rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër” (neni 1). Diskriminimi përkufizohet si “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë” (neni 2). Ligji përfshin që nga reklamat diskriminuese, deri tek pjesëmarrja në politikë, punësimi, arsimit dhe të mirat dhe shërbimet, dhe mbulon si sektorin publik ashtu edhe privat. Ai përcakton gjithashtu strukturën kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi, që është KMD.

2.3. Kodi Penal

Kodi Penal u ndryshua në vitin 2013 dhe tani përfshin orientimin seksual dhe identitetin gjinor si rrethana rënduese të veprave penale (neni 50j).

Shpërndarja e materialeve homofobike nuk penalizohet, siç kriminalizohet për shembull shpërndarja e materialeve me përmbajtje raciste apo ksenofobike (neni 119/a/b). Kodi Penal kriminalizon gjuhën e urrejtjes vetëm për shkaqe të orientimit seksual (neni 265), duke e lënë të patrajtuar çështjen e identitetit gjinor. Kodi ndalon diskriminimin e personave nga ana e punonjësit me funksion shtetëror për arsye të orientimit seksual dhe identitetit gjinor (neni 253). Kodi Penal i Shqipërisë nuk ofron mbrojtje nga gjuha transfobike (neni 265) dhe nga nxitja tendencioze e urrejtjes homofobike dhe transfobike (neni 119/a/b); ai nuk penalizon dhunën homofobike dhe transfobike në formën e kanosjes për shkak të Orientimit Seksual

dhe Identitetit Gjinator (neni 84); ai penalizon punëtorët konsensualë të seksit dhe punën transseksuale si “prostitucion” (nenet 107-113); dhe i referohet marrëdhënieve të detyruara brenda seksit si “homoseksuale” (neni 105).

Për sa i përket ndërhyrjeve të panevojshme mjekësore në personat interseks, Kodi Penal nuk përmban asnjë dispozitë, sepse kjo çështje trajtohet nga Ligji për Kujdesin Shëndetësor dhe Ligji për Shëndetin Riprodhues që ndalojnë çdo ndërhyrje pa pëlqimin paraprak të vetë personit, por pëlqimi në rastin e fëmijëve jepet nga prindërit ose kujdestarët e tyre ligjorë, sepse fëmijët janë të mitur dhe nuk kanë kapacitet ligjor.

Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (2015), cakton detyrimet që kanë bashkitë, si njësitë e vetme administrative në nivel lokal përkundrejt banorëve të saj, përfshi edhe personat LGBTI+. Neni 3 i këtij ligji ndër të tjera, garanton se vetëqeverisja vendore duhet të bëhet “në respekt të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera.” Po ashtu, Neni 123 i të njëjtit ligj përcakton edhe përgjegjësinë e bashkive për të ofruar shërbime sociale në territorin e tyre për të gjithë banorët, përfshi edhe strehimin social. Ligji për Arsimin Para-universitar në Shqipëri (2013) në vijim të rekomandimeve të institucioneve të të drejtave të njeriut dhe në zbatim të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, përfshiu për herë të parë edhe mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të orientimit seksual, por la jashtë për arsye që nuk dihen identitetin gjinor. Ndër të tjera ligji parashikon ngritjen e Komisioneve të Etikës pranë çdo shkolle për të trajtuar rastet e dhunës apo diskriminimit ndaj fëmijëve apo edhe mësuesve.

2.4. Ligji “Për Shërbimet e Kujdesit Shëndetësor”

E drejta për kujdes shëndetësor është e garantuar në Kushtetutë. Kujdesi shëndetësor publik është përgjegjësi themelore e qeverisë dhe Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” garanton të drejtën e shëndetit për të gjithë.

I gjithë dokumentacioni legjislativ në fushën e kujdesit shëndetësor është gjenerik dhe nuk përmend në veçanti Orientimin Seksual dhe Identitetin Gjinator ose nevojat shëndetësore të personave LGBTI+. Duke qenë se baza ligjore parashikon kujdesin shëndetësor për të gjithë, personat LGBTI+ përfitojnë nga shërbimi shëndetësor mbi të njëjtat baza si qytetarët e tjerë. Edhe LMD ndalon diskriminimin për shkak të Orientimit Seksual apo Identitetit Gjinator.

E drejta për kujdesin shëndetësor riprodhues, sigurime shëndetësore dhe shëndetin mendor u njihet të gjithëve, por personat LGBTI+ nuk i gëzojnë ato në praktikë - personat gei dhe

lezbique nuk kanë qasje në teknologjinë e riprodhimit të asistuar (TRA), personave transgjinorë nuk u ofrohet kirurgji për ricaktimin e seksit (KRS) në spitalet publike, dhe shpenzimet për KRS dhe TZH nuk mbulohen nga skemat e sigurimeve shëndetësore. Personat interseks i detyrojnë të bëjnë ndërhyrje mjekësore, çka është në kundërshtim me të drejtën e tyre për integritet trupor. Personat LGBTI+ kanë të drejtë të përfitojnë nga shërbimet e kujdesit shëndetësor mbi të njëjtat baza si qytetarët e tjerë, por atyre u mungon qasja e plotë në shërbimet shëndetësore dhe vuajnë nga cilësia e dobët e shërbimeve.

Të dhënat për klientë/et LGBTI+ mungojnë plotësisht, sepse Orientimi Seksual apo Identiteti Gjinator nuk shënohet në kartelat mjekësore. Është e vështirë të hartohen politika për shëndetin e personave LGBTI+ në mungesë të statistikave. Zakonisht mjekët prezumojnë automatikisht se personi është heteroseksual, çka sjell që nevojat specifike shëndetësore që lidhen me Orientimin Seksual apo Identitetin Gjinator mbeten pa u diskutuar. Plani i Veprimit për Shëndetin Mendor për vitet 2013-2022 nuk i përmend personat LGBTI+ si grup i rrezikuar nga mendimet për vetëvrasje. Nuk është bërë ndonjë anketim shëndetësor për nevojat shëndetësore të personave LGBTI+ dhe programet e shkollave për profesionistët në fushën e shëndetësisë nuk trajtojnë të drejtat e personave LGBTI+ për kujdes shëndetësor.

2.5. Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”

Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, është miratuar në shkurt të vitit 2017 dhe ka hyrë në fuqi tre muaj pas miratimit, pra në qershor të vitit 2017. Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës (neni 1). Bazuar në këtë ligj, realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke zbatuar këto parime: 1. Fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive. 2. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën.

3. Barazia dhe mosdiskriminimi. 4. Përgjegjësia parësore e prindit dhe kujdestarit për t'i krijuar kushtet e jetesës, për t'i garantuar mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin fëmijës. 5. Ndarja e përgjegjësive ndërmjet prindit ose kujdestarit të tij, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë për mbrojtjen e fëmijës. 6. Çdo fëmijë duhet të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe ndarja e fëmijës nga familja duhet parë si zgjidhja e fundit. 7. Decentralizimi i shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijës,

ndërhyrja ndërsektoriale dhe partneriteti ndërmjet institucioneve publike e jopublike, të autorizuar me ligj. 8. Ofrimi i shërbimit të personalizuar e të specializuar për çdo fëmijë. 9. Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës. 10. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. 11. Garantimi i stabilitetit e vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimin e fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor. (neni 5, “parime të përgjithshme”). Me këtë ligj, një rregullim i veçantë parashikohet për fëmijët me aftësi të kufizuar (neni 32) dhe atyre që i përkasin pakicave kombëtare (neni 33).ⁱⁱⁱNë këtë kuadër, VKM nr. 578, shpjegon qartësisht procedurat për fëmijët në nevojë për mbrojtje ose në nevojë emergjente për mbrojtje. Në rast se fëmija është LGBTI+ dhe është futet në kategorinë e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, duhen ndjekur procedurat që parashikon VKM përkatëe dhe protokoli i mbrojtjes së fëmijës.

Duke parë këtë përmbajtje të kuadrit ligjor mund të themi që, pavarësisht se legjislacioni shqiptar është relativisht progresiv në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI+, ka ende një hendek të madh në zbatimin e ligjeve të miratuara. Ekziston një boshllëk i madh mes situatës ligjore dhe realitetit me të cilin përballen personat LGBTI+. Aleanca Kundër Diskriminimit LGBTI+ ka identifikuar raste dhune, diskriminimi dhe sulme ndaj komunitetit LGBTI+ bazuar në rastet që raportohen nga vetë personat e komunitetit në zyrat e saj. Për më tepër ende mungojnë dy ligje themelore që lidhen me respektimin e të drejtave të personave LGBTI+: ligji për barazinë e martesave që do lejonte që dy persona gej, lezbike apo biseksual të martohen dhe ligji për njohjen e gjinsë që do lejonte që personat transgjinerë të kryejnë ndërhyrje mjekësore dhe administrative në mënyrë që të përputhen me gjininë e tyre.

III. ZHVILLIMI I IDENTITETIT TË FËMIJËVE DHE TË RINJVE LGBTI+

Identiteti gjinor dhe seksual, i cili zakonisht zhvillohet gjatë adoleshencës, shërben si aspekt i rëndësishëm i identitetit të përgjithshëm për veten⁸⁹ (e.g., Erikson, 1968; Marcia, 1980). Personat LGBTI+ kalojnë në faza të ngjashme zhvillimi me ata heteroseksualë. Për të rinjtë LGBTI+, rëndësia e këtyre identiteteve për një identitet pozitiv të vetes mund të jetë edhe më i rëndësishëm, sepse ata shpesh janë target i stigmatizimit. Një nga vështirësitë me të cilat përballen të rinjtë LGBTI+ është mungesa e informacionit mbi gjininë, seksualitetin dhe zhvillimin e identitetit seksual.¹⁰¹¹ (Daley & MacDonnell, 2011; Morrow, 2004),

Në Shqipëri, edhe kur janë bërë përpjekje për të shtuar informacion mbi seksualitetin në kurrikulat shkollore, nuk është arritur të përfshihet informacion që përfshin komunitetin LGBTI+ ose të adresohen në mënyrën e duhur tema të identitetit gjinor apo orientimit seksual. Në Shqipëri, të drejtat e personave LGBTI nuk janë të përfshira në edukimin seksual formal apo në programet e përgjithshme mësimore kombëtare të arsimit parauniversitar. Nga përvoja e Strehës dhe Aleancës LGBT, shumë fëmijë dhe adoleshentë LGBTI+, kanë treguar se gjatë fëmijërisë dhe adoleshencës e kanë fshehur faktin e të qenit pjesë e komunitetit LGBTI+, duke menduar se kjo ishte e gabuar dhe se ishin të vetëm në llojin e tyre, sepse u mungonte informacioni dhe sepse në mënyrë të ndërgjegjshme ose jo, te dukshme ose jo të drejtpërdrejtë e ndjenin se nëse dilnin hapur pasojat do të ishin shumë negative

Zakonisht, modelet e zhvillimit të adoleshentëve i japin rëndësi gjetjes së kuptimit të vetes, gjë që si pasojë sjell tërheqjen, intimitetin dhe marrëdhëniet me të tjerët (Erikson, 1968).

Përgjatë dekadave, modelet e zhvillimit të identitetit seksual, veçanërisht për të rinj LGBTI+, kanë ndryshuar nga modele fazash lineare¹²(e.g., Cass, 1979; Troiden, 1979)¹³ në modele më fluide, komplekse dhe të varura nga kontekstet (Bilodeau & Renn, 2005; Diamond, 1998;

⁸ Erikson, E. (1968). *Identity: Youth and crisis*. New York: Norton.

⁹ Marcia, J. E., (1980). *Identity in adolescence*. In J. Adelson (Ed.), *Handbook of adolescent psychology*. New York: Wiley.

¹⁰ Daley, A. E., & MacDonnell, J. A. (2011). *Gender, sexuality and the discursive representation of access and equity in health services literature: Implications for LGBTI communities*. *International Journal for Equity in Health*, 10(40).

¹¹ Morrow, D. F. (2004). *Social work practice with gay, lesbian, bisexual, and transgender adolescents*. *Families in Society*, 85, 91–99

¹² Cass, V. C. (1979). *Homosexual identity formation: A theoretical model*. *Journal of Homosexuality*, 4(3), 219–235

¹³ Troiden, R. R. (1979). *Becoming homosexual: a model of gay identity acquisition*. *Psychiatry*, 42, 362–373.

Rosario Schrimshaw, & Hunter, 2006)¹⁴ ¹⁵. Megjithatë, shumica e modeleve të zhvillimit përmbajnë këto shenja dalluese:

1. Ndërgjegjësimin për orientimin LGBTI+;
2. konfuzioni midis asaj që ndjejnë dhe normave sociale;
3. të etiketuarit e vetes si LGBTI+;
4. të treguarit e identitetit LGBTI+ njerëzve të tjerë, zakonisht së pari te njerëz të

tjerë LGBTI+, pastaj tek shokë të ngushtë, bashkëmoshatarë të tjerë, të rritur dhe më në fund tek anëtarë të familjes; dhe në disa modele, duke u përfshirë më shumë në komunitete me anëtarë LGBTI+ (D'Augelli, Hershberger, & Pilkington, 1998; Diamond, 1998; Doty, Malik, & Lindahl, 2012; Floyd & Stein, 2002; Maguen, Floyd, Bakeman, & Armistead, 2002; Rosario, Schrimshaw, & Hunter, 2008)¹⁶.

Zhvillimi i orientimit seksual në faza mund të mos të përfshijë plotësisht kompleksitetin e jetës së vërtetë, me gjithë kapërcimet e veta, hapat e munguar, dhe fazat që ndodhin jashtë radhës. Gjithsesi, studimet të lidhura me personat LGBTI+ tregojnë se shumica e kanë dalluar orientimin e tyre seksual gjatë adoleshencës dhe ndërgjegjësimi mbi tërheqjen erotike ndaj të njëjtit seks zakonisht i paraprinte pubertetit (Cohler, 2000).

Harter (1990; 1998)¹⁷ sugjeron se për të rinjtë në përgjithësi, përdorimi i etiketave gjatë zhvillimit të identitetit, i ndihmon adoleshentët të shikojnë aspekte të ndryshme të vetes së tyre si pjesë e një e tërë. Dalja hapur apo etiketimi publik i vetes si LGBTI+, lidhet me shëndet psikosocial të përmirësuar (Corrigan & Mattheës, 2003; Koscië, Greytak, Bartkiewicz, Boesen, & Palmer, 2012); megjithatë procesi shoqërohet me stresorë të rëndësishëm, si bullizmi, i cili çon në rezultate të ulëta akademike dhe vetëvrasje (Craig & Smith, 2011; Grossman & Kerner, 1998; Hatzenbuehler, 2011; Katz-Ëise & Hyde, 2012; Mercier & Berger, 1989; Meyer, 2003; Williams, Connolly, Pepler, & Craig, 2005), rrezik që rritet kur të rinjtë targetohen veçanërisht si LGBTI+ (Kosciw et al., 2012; Russell, Sinclair,

¹⁴ Bilodeau, B. L., & Renn, K. A. (2005). Analysis of LBGT identity development models and implications for practice. In R. L. Sanlo (Ed.), *Gender identity and sexual orientation: Research, policy, and personal perspectives* (Neë Directions for Student Services, no. 111, pp. 25-39). San Francisco: Jossey-Bass.

¹⁵ Diamond, L. M. (1998). Development of sexual orientation among adolescent young adult women. *Developmental Psychology*, 34, 1085–1095.

¹⁶ In Palmer, N. A. (2013). *LGBTI youth online and in person: Identity development, social support, and extracurricular and civic participation in a positive youth development framework*. Dissertation & Thesis.

¹⁷ Harter, S. (1998). The development of self-representation. In N. Eisenberg (Ed.), *Handbook of child psychology* (5th ed.), Vol. 3: Social, emotional, and personality development (pp. 553-567). New York: Wiley

Poteat, & Koenig, 2012; Toomey, Ryan, Diaz, Card, & Russell, 2010)¹⁸. Për shkak të këtyre pasojave negative, të rinjtë LGBTI+ e kanë të vështirë të dalin hapur.

Nga praktika e punës me persona LGBTI+ në Shqipëri, është vënë re se ata ndeshen me diskriminim dhe dhunë gjatë gjithë ciklit të jetës për shkak të normave patriarkale dhe sjelljeve homofobike të cilat janë të rrënjosura fort në shoqërinë tonë Rreziku për të qenë subjekt i dhunës apo diskriminimit rritet dukshëm në zonat jashtë kryeqytetit të Shqipërisë, ku mungojnë shërbimet në ndihmë të personave LGBTI+ apo raportimi në polici apo në institucione të tjera bëhet i pamundur, për shkak të turpit dhe stigmës. Pavarësisht se realiteti në Tiranë është po aq i vështirë për shumë të rinjë LGBTI+, sërish ka disa vende miqësore për personat LGBTI+ (bare, organizata, shërbime shëndetësore dhe stacione policie) ku ata mund të jenë më të lirshëm për të qenë vetvetja. Ndërkohë në zonat të tjera të Shqipërisë realiteti është edhe më i vështirë. Shumë të rinj fshehin orientimin e tyre, nga frika se do të humbasin rrethin e miqve, mund të refuzohen nga familja, apo mund të jenë në rrezik për të përjetuar dhunë. Kur marrin shërbime pranë Strehës apo Aleancës, shumë prej tyre raportojnë se kur kanë qenë pranë familjeve të tyre kanë menduar shumë herë vetëvrasjen, janë ndjerë të ndrydhur dhe kanë jetuar me frikën e zbulimit të orientimit seksual. Kjo ka sjellë shpesh ndjenja faji të lidhura me brendësimin e homofobisë së madhe më të cilën janë përballur.

Në zona të ndryshme të Shqipërisë (sidomos në ato rurale) anëtarët e komunitetit LGBTI+ jetojnë të fshehur, nuk e shfaqin veten as midis anëtarëve të të njëjtit komunitet dhe preferojnë të vendosin kontakt me anëtarë të komunitetit që jetojnë në qytete të tjera për t'ju shmangur më shumë rrezikut. Ata ndeshen me të njëjtën mendësi të pandryshueshme, që i detyron të fshehin sjelljet që nuk konformojnë me normat gjinore dhe heteroseksizmin. nën frikën e një ndëshkimi ekstrem apo u ushtron presion për t'u martuar me një person të gjinisë së kundërt (sidomos vajzat lezbike, të cilat jo rrallë martohen me shkesi). Ndonjëherë disa të rinj na kanë pohuar se jetojnë me frikën se nëse prindërit e tyre do ta zbulonin, reagimi i tyre do të ishte në ekstrem, veçanërisht nga ana e baballarëve.

¹⁸ In Palmer, N. A. (2013). LGBTI youth online and in person: Identity development, social support, and extracurricular and civic participation in a positive youth development framework. Dissertation & Thesis.

Kur ata marrin shërbime afirmative raportojnë më pak ndjenja vetmie, më shumë optimizëm për të ardhmen, përmirësim të marrëdhënieve me të afërmit dhe miqtë, dalje nga izolimi, më pak konfuzion dhe rritje të vetëvlersimit. Kjo ndodh sepse:

- gjenden në një ambjent pranues dhe janë në kontakt me persona të tjerë të komunitetit;
- marrin shërbime të nevojshme si për shembull shërbimet psiko-sociale dhe janë në kontakt me staf pranues dhe mbështetës,

Të rinjtë që në kryeqytet fuqizohen duke qenë pjesë e organizatave LGBTI+, paradave gej apo pjesë e komunitetit LGBTI+, kur kthehen në familjet e tyre në rrethe të ndryshme të Shqipërisë, dëshmojnë për përballimin e të njëjtave vështirësi si më përpara.

D'Augelli dhe Hershberger (1993) zbuluan se të rinjtë LGBTI+ edhe pse e zbulonin identitetin e tyre seksual në moshën 10 vjeç, nuk e ndanin këtë informacion përpara moshës 16 vjeç, sepse kanë frikë se do të humbasin mbështetjen e miqve dhe të familjes për shkak të orientimit seksual. Në eksperiencën e Strehës dhe të Aleancës me personat LGBTI+ në Shqipëri, adoleshentët dëshmojnë se janë më të rrezikuar për pësimin e veprimeve të dhunshme dhe subjekte të diskriminimit, ndoshta sepse ata:

- nuk janë të përgatitur për të dalë hapur (u mungon informacioni, nuk e kanë pranuar veten plotësisht etj),
- nuk kanë informacionin e duhur mbi mjedisin që i rrethon (nuk janë të ndërgjegjshëm mbi mjedisin homofobik apo dhunën që e shoqëron),
- nuk kanë mbështetjen e duhur nga miqtë apo familjarët dhe
- nuk janë në gjendje të mbrojnë veten e tyre, duke qenë se janë ende të varur financiarisht nga familjet e tyre dhe në moshë të mitur.

Duke qenë viktima të bulizmit, kanë qenë të detyruar të ndërpresin arsimin (e mesëm, të lartë); apo më keq akoma janë dëbuar nga shtëpitë, duke humbur përfundimisht marrëdhëniet me të gjithë të afërmit dhe duke u gjendur në situatë rruge. Dhuna, vetmia dhe izolimi janë bërë pjesë e jetës së tyre duke ndikuar dukshëm në vështirësi të lidhura meshëndetin mendor.

Përvoja të të njëjtës gjini nuk e sinjalizojnë domosdoshmërisht dikë me identitet gej, lezbike apo biseksual (Blumenfeld and Raymond, 1993).¹⁹ Nga ana tjetër, adoleshentët mund të identifikohen si gej, lezbike apo biseksualë, pa patur ndonjë përvojë seksuale (Ryan and Futterman, 1998; Savin-Williams, 1990)²⁰²¹. Diversiteti i përvojave individuale të adoleshentëve që identifikohen si lezbike, gej apo biseksualë nxjerr në pah nevojën për të konsideruar modele të shumta zhvillimi.

Augelli përshkruan gjashtë “procese identiteti” që veprojnë pak a shumë në mënyrë të pavarur dhe nuk renditen në faza:

1. Heteroseksualiteti ekzistues
2. Zhvillimi i identitetit personal LGBTI+
3. Zhvillimi i identitetit social LGB TI+
4. Të jesh një person LGB TI+
5. Të zhvillosh status intimiteti LGB TI+
6. Të hysh në një komunitet LGB TI+

3.1. Përkufizimet e lidhura me identitetet transgjinore

Termi identitet gjinor është përdorur për të përshkruar kuptimin e brendshëm të një individi si burrë, grua, ose një identitet mes këtyre dy kategorive (Wilchins, 2002)²². Termi transgjinor fokusohet tek individët, identiteti gjinor i të cilëve është në konflikt me atë që është përcaktuar nga seksi biologjik ose pritshmëritë e shoqërisë për shprehjen gjinore si mashkull apo femër (Bornstein, 1994; Elkins and King, 1996; Wilchins, 1997, 2002)²³²⁴²⁵.

Termi transgjinor përdoret shpesh si një kategori gjithëpërfshirëse për një gamë të gjerë identitetesh, duke përfshirë transeksualët, transvestitët, ata që imitojnë burrat dhe gratë, burra që vishen si gra apo gra si burra, persona burrë-në-grua (person që ka lindur burrë por

¹⁹ Blumenfeld, W. J., and Raymond, D. *Looking at Gay and Lesbian Life*. (2nd ed.) Boston: Beacon Press, 1993.

²⁰ Ryan, C., and Futterman, D. *Lesbian and Gay Youth: Care and Counseling*. New York: Columbia University Press, 1998.

²¹ Savin-Williams, R. C. “Gay and Lesbian Adolescents.” *Marriage and Family Review*, 1990, 14, 197–216.

²² Wilchins, R. A. (2002). “Queerer Bodies.” In J. Nestle, C. Howell, and R. A. Wilchins (eds.), *Genderqueer: Voices from Beyond the Sexual Binary*. Los Angeles: Alyson.

²³ Bornstein, K. (1994). *Gender Outlaw: On Men, Women and the Rest of Us*. New York: Routledge.

²⁴ Elkins, R., and King, D. (1996). “Blending Genders—An Introduction.” In R. Elkins and D. King (eds.), *Blending Genders: Social Aspects of Cross-Dressing and Sex Changing*. New York: Routledge.

²⁵ Wilchins, R. A. (1997). *Read My Lips: Sexual Subversion and the End of Gender*. New York: Firebrand Books.

adopton identitetin apo pamjen e një gruaje, etj (Bornstein, 1994; Feinberg, 1996; O’Keefe and Fox, 1997; Wilchins, 1997, 2002)²⁶²⁷. Këto terma përdoren më shpesh në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndërkohë që në një numër të madh shoqërisht jo perëndimore, identitetet transgjimore përcaktohen me një terminologji unike që reflekton normat kulturore (Besnier, 1993; Broën, 1997; Johnson, 1997)²⁸²⁹³⁰. Studimet mbi personat transgjimorë janë të rralla, dhe ndryshimi mes orientimit seksual dhe identitetit gjimor nuk kuptohet gjithmonë shumë mirë (Bilodeau, 2005)³¹. Në Shqipëri, personat transgjimorë të cilët nuk mund ta fshehin dot lehtë identitetin e tyre, janë personat që vuajnë më së tepërmi nga diskriminimi dhe dhuna. Ata përjetojnë diskriminim dhe dhunë në familje, në punë, në ambjentin shkollor, në marrjen e shërbimeve të ndryshme sidomos atyre mjekësore. Në një studim të Strehës mbi aksesin në drejtësi të personave LGBTI+³², . Ata nuk mund të marrin dokumente në gjininë e tyre të preferuar për shkak të mungesës së ligjit specifik. Ashtu sikurse nuk mund të kryejnë, ndërhyrje kirurgjikale për ricaktimin e seksit..

Prania e atipikes apo mospërputhjes gjimore nuk nënkupton patjetër identitetin transgjimor. Studimet e pakta të realizuara tregojnë se relativisht pak djem me mospërputhje gjimore bëhen të rritur transgjimorë dhe shumica bëhen të rritur gej.

IV. SFIDAT E FËMIJËVE DHE TË RINJVE LGBTI+

4.1. Çfarë është Bullizmi?

Bullizmi mund të përfshijë ngacmimin, përqeshjen, përdorimin e pseudonimeve denigruese, manipulimin psikologjik, dhunën fizike apo përjashtimi social. Një person që ushtron bullizmin mund të veprojë vetëm ose brenda nje grupi moshatarësh. Ngacmimi mund të jetë i

²⁶ Feinberg, L. (1996). *Transgender Warriors: Making History from Joan of Arc to Dennis Rodman*. Boston: Beacon Press.

²⁷ O’Keefe, T., and Fox, K. (1997). *Trans-x-u-all: The Naked Difference*. London: Extraordinary People Press.

²⁸ Besnier, N. “Polynesian Gender Liminality Through Time and Space.” In G. Herdt (ed.), *Third Sex, Third Gender: Beyond Sexual Dimorphism in Culture and History*. New York: Zone Books, 1993.

²⁹ Brown, L. B. “Women and Men, Not-Men and Not-Women, Lesbians and Gays: American Indian Gender Style Alternatives.” In L. B. Brown (ed.), *Two Spirit People: American Indian Lesbian Women and Gay Men*. New York: Harrington Park Press, 1997.

³⁰ Johnson, M. *Beauty and Power: Transgendering and Cultural Transformation in the Southern Philippines*. New York: Berg, 1997.

³¹ Bilodeau, B. “Beyond the Gender Binary: A Case Study of Transgender College Student Development at a Midwestern University.” *Journal of Gay and Lesbian Issues in Education*, 2005, 2(4).

³² Streha, Pengesat e Hasura nga Komuniteti LGTBTI në Marrjen e Shërbimeve Ligjore dhe Aksesit në Drejtësi, Tetor 2018.

drejtpërdrejtë psh. një fëmijë i kërkon para fëmijës tjetër, ose i tërthortë, psh një grup nxënësish përhap thashethemet në lidhje me një nxënës tjetër. Bullizëm përmes internetit është ngacmimi nëpërmjet e-mailit, telefonave celularë, mesazheve me tekst dhe hapja e faqeve ofenduese të internetit.

Fëmijët mund të jenë më të prekshëm nga bullizmi në qoftë se ata janë me aftësi të kufizuara, shprehin një preferencë seksuale të ndryshme nga e zakonshmja, ose vijnë nga një minoritet etnik apo kulturor ose një grup i caktuar social-ekonomik. Si për personin që ushtron bullizmin ashtu edhe për atë që e pëson atë, bullizmi rezulton në vështirësi ndërpersonale dhe performancë të dobët në shkollë. Fëmijët të cilët janë keqtrajtuar kanë më shumë të ngjarë se bashkëmoshatarët e tyre të vuajnë nga depresioni, të jenë të vetmuar, ose të shqetësuar dhe kanë vetëbesim të ulët. Fëmijët që pësojnë bullizëm shpesh veprojnë në mënyrë agresive si pasojë e poshtërimit, zemërimit, frustrimit, dhe në përgjigje të talljes shoqërore.

Çfarë është bullizmi homofobik?

Bullizmi homofobik është një sjellje apo gjuhë e cila e bën një person të mos ndihet i mirëpritur ose të jetë i marginalizuar prej orientimit seksual apo identitetit gjinor aktual ose të supozuar.

Faktorët kryesorë të cilët ndikojnë që një person të bëhet target i bullizmit homofobik janë:

- Njerëzit supozojnë që personi tjetër ka një orientim seksual të caktuar, sepse ai i përshtatet stereotipit lezbik, gej, biseksual ose trangjinor. Këto stereotipe janë të bazuara në një model shoqëror të cilat përfshijnë rolet gjinore tradicionale ose tipare të cilat janë të pasakta. Psh. djem me zë të hollë e të butë, vajza me flokë të shkurtër.
- Nëse ai mbron ose flet hapur në lidhje me të drejtat civile të minoriteteve seksuale
- Nëse dikush ka familjarë ose shokë LGBTI+
- Nëse perceptohet si i ndryshëm nga njerëzit e tjerë të komunitetit të tij lokal.

Si shfaqet bullizmi homofobik?

Ashtu si të gjitha format e bullizmit, bullizmi homofobik mund të ndodhë në mënyra të ndryshme si emocionale, verbale, fizike apo seksuale.

Disa nga format më të zakonshme të bullizmit homofobik përfshijnë:

- Bullizmi verbal (të ngacmohet ose të thërrasësh dikënd me pseudonim odendues, përdorimi i termave nënçmues për të përshkruar dikë, ose përdorimi i gjuhës së urrejtjes)
- Krahasimi me njëzëz LGBTI+ të famshëm, personazhe ose karaktere që portretizojnë stereotipe të veçanta të njerëzve LGBTI+.
- Kërcënimi që i bëhet dikujt në lidhje me ekspozimin e orientimit të tij seksual tek miqtë ose familja edhe në raste kur dikush nuk është LGBTI+
- Bullizmi indirekt / përjashtimi social (injorosh dhe mënjano)

Bullizmi fizik

- Ngacmimi seksual (gjeste seksuale të papërshtatshme, për shembull, në dhomën e zhveshjes pas fizkulturës ose presioni duke përdorur komente të tilla si 'ti e di që të pëlqen!')
- Bullizmi nëpërmjet internetit (ngacmimi, përdorimi i notave ofenduese, kërcënimi nëpërmjet mesazheve, email-it dhe mediave sociale)

Cilat janë efektet e mundshme të bullizmit homofobik?

Të gjitha format e bullizmit mund të ndikojnë në gjendjen emocionale dhe mirëqënien sociale të fëmijëve apo të rinjve, si edhe në shëndetin e tyre fizik. Kjo mund të çojë në heqjen dorë nga ndërveprimet sociale në klasë ose aktivitete të tjera shkollore të cilat më përpara i pëlqenin, ulje e performancës akademike, mungesa pa arsye, largimin nga shkolla apo lënia e shkollimit më herët se normalisht. Sa serioze janë efektet mbi një fëmijë apo të riu varet tërësisht nga individit dhe mekanizmat e tij përballuese dhe gjithmonë njerëzit përgjigjen ndaj bullizmit në mënyra të ndryshme.

Personat LGBTI+ mund të përballen me qëndrime negative dhe paragjykime në komunitetet e tyre lokale dhe kërkimet kanë provuar se si rezultat i tyre, të rinjtë LGBTI+ janë veçanërisht të prirur për shëndet mendor të dobët. Kjo mund të çojë disa të rinj LGBTI+ në përvetësimin e ndjenjave si homofobia e brendësuar.

Kjo mund të nënkuptojë:

- Mohimi i orientimit të tyre seksual tek vetja apo të tjerët ose përpjekje të tjera për të ndryshuar orientimin e tyre seksual.
- Vetëvlerësim i dobët dhe / ose imazh negativ për trupin e tyre
- Një mospëlqim ndaj personave të hapur apo që qartazi janë LGBTI+.
- Turp, depresion, vetëmbrojtje, zemërim apo hidhërim
- Vetë-tallje për të fituar pranim social nga shokët dhe kolegët
- Marrjen përsipër të sjelljeve të rrezikshme të cilat përfshijnë abuzimin me substanca
- Mendimet për vetëdëmtim dhe / ose për vetëvrasje

Reagimi ndaj gjuhës homofobike dhe bullizmit në shkollë

Gjuha homofobike është e zakonshme në shkollë, por në qoftë se ajo nuk ndalohej, nxënësit mund të mendojnë se bullizmi homofobik është i pranueshëm. Prandaj është e rëndësishme që gjuha homofobike të ndalohej në momentin që ndodh:

- Sigurohuni që nxënësit të dinë se gjuha homofobike nuk do të tolerohet në shkollë. Sigurohuni që ajo të përfshihet në politika dhe procedura që e ndalojnë dhe ndëshkojnë përdorimin e saj.
- Kur ndodh një incident, nxënësit duhet të jenë të informuar se gjuha homofobike është ofenduese, dhe nuk do të tolerohet.
- Nëse një nxënës vazhdon të bëjë komente homofobike, shpjegojini në detaje efektet që ngacmimet homofobike kanë mbi njerëzit.
- Nëse një nxënës bën komente të vazhdueshme, ata duhet të hiqen nga klasa, mësuesit dhe stafi duhet të bisedojnë me të për sa më shumë detaje në lidhje me arsyen pse komentet e nxënësit janë të papranueshme.
- Nëse problemi vazhdon, përfshini edhe drejtues më të lartë. Nxënësit duhet të kuptojnë që sanksionet që do të zbatohen në qoftë se ata vazhdojnë të përdorin gjuhën homofobike janë serioze.
- Ftoni prindërit / kujdestarët e tyre në shkollë për të diskutuar qëndrimet e nxënësit.

4.2. Dhuna në familje

Abuzimi i fëmijës ose “keqtrajtimi” ka të bëjë me të gjitha format e keqtrajtimit fizik, dhe/ose emocional, abuzimin seksual, neglizhimin ose trajtimin neglizhues, ose forma të ndryshme të shfrytëzimit komercial.

Këto forma rezultojnë në dëmtim të mundshëm ose real të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit ose dinjitetit të fëmijës në kontekstin e një marrëdhënie përgjegjësie, besimi ose pushteti.

Abuzimi fizik është dëmi fizik aktual ose i mundshëm, nga një veprim ose mosveprim ndaj një fëmije, i cili është nën kontrollin e prindit ose personit që ka përgjegjësinë, fuqinë ose besimin. Mund të ketë incidente të vetme ose të përsëritura. Fëmijët e komunitetit LGBTI+ bien shpesh viktime të abuzimit fizik në momentin kur familjarë, të afërm ose shokë dhe shoqe shkolle kuptojnë që fëmija është LGBTI+ ose e perceptojnë si të tillë.

Abuzimi seksual i një fëmije është përfshirja e tij në aktivitete seksuale që ai/ajo nuk i kupton, nuk është në gjendje të japë miratimin, ose për të cilat fëmija nuk është përgatitur nga ana e zhvillimit ose nuk mund të kuptojë, ose që dhunojnë ligjet ose tabutë sociale të shoqërisë. Abuzimi seksual i fëmijës është evidentuar si një aktivitet midis fëmijës dhe një të rrituri ose një fëmije tjetër, i cili nga mosha apo zhvillimi, është në marrëdhënie përgjegjësie, besimi ose pushteti, dhe ky aktivitet ka si qëllim të plotësojë nevojat e personit tjetër. Kjo mund të përfshijë, por mund të mos kufizohet vetëm në nxitjen, ose detyrimin e fëmijës të përfshihet në akte seksuale të paligjshme, shfrytëzimin e fëmijës në praktika pornografike ose seksuale, fotografitë dhe materialet në internet. Përdorimi më i fundit i teknologjisë, si interneti nga të rriturit për të joshur fëmijët që t'i takojnë ose të marrin pjesë në seks virtual, është gjithashtu abuzim. Sikurse për abuzimin fizik edhe për abuzimin seksual fëmijët LGBTI+ janë të rrezikuar të abuzohen seksualisht nga të afërm dhe familjarë.

Targetgrupet më të rrezikuara nga abuzimi seksual janë djemtë gej, vajzat transgjimore si dhe vajzat lezbike. Është me rëndësi të përmendet fakti se abuzimi seksual kundrejt fëmijëve LGBTI+ ndodh zakonisht kur orientimi seksual apo identiteti i tyre gjinor është dallueshëm ose perceptohet si i tillë. Gjithashtu në pjesën më të madhe të rasteve abuzimi seksual shoqërohet me shantazhime me lidhje me bërjen publike të orientimit seksual apo identitetit gjinor. Këto shantazhime pengojnë fëmijën të flasë me prindin, mësuesen, psikologun apo persona të tjerë në lidhje me problematikën që ndesh.

Abuzimi emocional përfshin mospërbushjen e detyrimit për të ofruar një mjedis të përshtatshëm mbrojtës, duke përfshirë disponueshmërinë e një imazhi kryesor atashues, që fëmija të arrijë potencialin e plotë në kushtet sociale ku jeton.

Mund të ketë edhe akte ndaj fëmijës, të tilla që shkaktojnë, ose kanë një mundësi të lartë t'i shkaktojnë dëm zhvillimit fizik, mendor, shëndetësor, moral, shpirtëror dhe social të fëmijës.

Këto akte duhet të jenë nën kontrollin e prindërve ose personit përgjegjës. Në ato përfshihen: kufizimi i lëvizjes, degradimi, poshtërimi, kërcënimi, diskriminimi, tallja apo forma të tjera trajtimi armiqësor dhe lënia mënjanë. Fëmijët LGBTI+ në Shqipëri janë shpesh herë viktimat e abuzimit emocional nga prindërit e tyre. Prindërit e një fëmije LGBTI+ duke mos patur informacionin e duhur mbi të qenit LGBTI+ shpesh herë ndëshkojnë, shantazhojnë, izolojnë, poshtërojnë ose dëbojnë fëmijën në momentin që fëmija informon prindin në lidhje me orientimin e tij seksual apo identitetin gjinor. Gjithashtu fëmija mund të abuzohet në të njëjtën formë nga prindi në momentin që perceptohet si LGBTI+. Abuzimi emocional ndaj fëmijës LGBTI+, ndodh jo vetëm në familje por edhe nga stafi pedagogjik në momentin që orientimi seksual apo identiteti gjinor i fëmijës bëhet publik apo fëmija perceptohet si i tillë. Abuzimi fizik ndaj një fëmije LGBTI+ shpesh herë shoqërohet dhe me shantazhimin e të bërit publik orientimin seksual apo identitetin gjinor të fëmijës.

Neglizhimi dhe trajtimi neglizhent është mungesa e vëmendjes ose shmangia nga ana e kujdestarit nga detyra për t'i dhënë zhvillimit të fëmijës: kujdes shëndetësor, arsimim, zhvillim emocional, ushqim, strehë dhe kushte të sigurta jetese, në kontekstin e burimeve të disponueshme për familjen ose kujdestarin dhe që shkakton apo që ka mundësi të lartë t'i shkaktojë dëm shëndetit të fëmijës ose zhvillimit të tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe social. Kjo përfshin mospërmblidhjen e detyrimit për të mbikëqyrur dhe mbrojtur si duhet fëmijët nga dëmtimet. Neglizhimi është një nga format më të përhapura të abuzimit ndaj fëmijëve LGBTI+ nga prindërit dhe familjarët në momentin kur orientimi i tyre seksual apo identiteti gjinor bëhet i ditur. Prindërit e fëmijëve LGBTI+ përdorin neglizhimin si formë shantazhimi ndaj fëmijës në mënyrë që fëmija kundrejt presionit prindëror të ndryshojë orientimin seksual apo identitetin gjinor.

Kur prindërit mësojnë se fëmija tyre është gej, lezbike ose biseksual apo transgjinor:

Më poshtë do të gjeni disa këshilla për situata të ndryshme në një familje ku fëmija del hapur në lidhje me orientimin seksual apo identitetin gjinor. Si profesionistë për mbrojtjen e fëmijës është e rëndësishme të dimë si të përballemi apo punojmë gjithashtu me familjet dhe prindërit në mënyrë që të parandalojmë dhunën dhe abuzimin e fëmijëve LGBTI+ në familje.

Shumica e prindërve nuk janë të përgatitur të dëgjojnë fjalët “Mami, babi, jam gej”. Nëse ju mendoni si pjesa më e madhe e prindërve, reagimi i parë do të jetë: “Si do ta përballoj këtë fakt”?

Aleanca LGBT dhe Qendra Streha mund t'ju mbështesë dhe t'ju japë informacione dhe ndihmën specifike për secilin prind apo profesionist që mund ta ndjejë të nevojshme.

Disa prindër arrijnë ta përballojnë qetësisht dhe shpejt lajmin, por shumë prej tyre përballen me një proces tronditës mohues, faji dhe ndjenjë humbjeje. Pra nëse këto janë ndjesitë me të cilat po përballen prindi apo kujdestari i fëmijës, janë krejt të kuptueshme kuke patur parasyh dhe qëndrimin e shoqërisë ndaj gejve, lezbikeve, biseksualëve dhe transgjjinorëve.

Prindi mund të ndjehet sikur e ka humbur fëmijën, por nuk është e vërtetë. Fëmija është i njëjti person siç ishte edhe më parë. E vetmja gjë që mund të ketë ndryshuar në përshtypjet për fëmijën, mund të jetë imazhi që prindi ka krijuar për atë. Ka shumë rëndësi të arrihet të mirëkuptohet fëmija kur është ende në moshë delikate.

Të rinjtë gej, lezbike, biseksualë dhe transgjjinor që mohohen nga prindërit e tyre, krahasuar me të rinjtë e tjerë jo homoseksualë, kanë një shkallë më të lartë vetëvrasjeje dhe abuzimi me drogën ose alkoolin.

Vendimi i fëmijës për të qenë i hapur dhe i ndershëm me prindin apo me këdo tjetër, për një çështje që shumë në shoqërinë tonë nuk marrin përsipër ta pranojnë, është tejet i guximshëm. Kjo tregon për një dashuri, besim dhe përkushtim po aq të madh të marrëdhënies së tij/saj me personin të cilit fëmija zgjedh ti dalë hapur. Kjo vlen si për prindërit po ashtu edhe për profesionistë të mbrojtjes së fëmijës.

A është fëmija juaj ndryshe?

Prindërit mendojnë se i njohin dhe i kuptojnë fëmijët e tyre që nga dita kur lindin. Ata janë kryesisht të bindur se e dinë sesi janë formuar fëmijët dhe se njohin këndvështrimet e tyre për çështje të ndryshme apo se ç'mendime kanë fëmijët e tyre në kokë. Prandaj, kur fëmija vendos të thotë “Jam gej, lezbike, biseksual, transgjjinor” dhe prindi apo kujdestari i fëmijës as që ia kishte idenë (ose e kishte dyshuar gjatë gjithë kohës, por nuk ka dashur ta pranojë), reagimet janë shpesh shokuese, keq-orientuese si dhe shpesh abuzuese kundrejt fëmijës.

Çdo prind ka një ëndërr, një imazh të asaj çka do të bëhet fëmija tij, një imazh të asaj që duhet të jetë ose një imazh të asaj që mund të jetë. Kjo ëndërr lidhet kryesisht me të shkuarën e prindit, me atë që prindi ka dëshiruar të bëhet vetë teksa rritej, kjo ëndërr ka gjithashtu të bëjë sidomos me kulturën përreth. **Shoqëria shqiptare ende na përgatit, nxit dhe orienton me ëndërra për fëmijë heteroseksualë edhe pse faktet flasin për një numër të konsiderueshëm të personave homoseksualë.**

Fëmijët gjithnjë na çudisin. Ata nuk martohen me kë mund ti ketë përzgjedhur prindi; nuk punon në punën që mund të dëshirojë prindi për të; nuk jeton aty ku do të donte familja që ata të jetonin. Megjithatë, në shoqërinë tonë jemi të përgatitur më mirë që të përballemi me situata të tilla sesa me orientimin seksual apo identitetin gjinor “jo tradicional” të fëmijës.

Pse duhej që fëmija ti tregonte prindit për orientimin seksual apo identitetin gjinor?

Disa prindër mendojnë se do të ishin më të lumtur po të mos mësonin të vërtetën për seksualitetin e fëmijës së tyre. Ndërsa shikojnë pas në kohën para se të informoheshin për orientimin seksual të fëmijëve ata kujtojnë se ishte një kohë pa probleme, duke e anashkuar shpesh distancën që ndjenin nga fëmija i tyre gjatë asaj kohe.

Ndonjëherë prindërit kanë tendencën të mohojmë atë çka po ndodh në realitet - duke mos pranuar çka dëgjojmë (“*Është vetëm një fazë; do të të kalojë*”); duke paralajmëruar (“*Nëse do të zgjedhësh atë mënyrë jetese, nuk dua të dëgjoj më rreth saj*”), ose duke mos e regjistruar ndikimin e asaj që fëmija me shumë mund vendos ti thotë (“*Diskutojmë më mirë në një moment tjetër?*”). Të gjitha këto janë reagime të kuptueshme për prindërit por gjithashtu mund të rezultojnë të dëmshme për fëmijën .

Megjithatë nëseprindërit nuk do të dinin të të vërtetën për seksualitetin e fëmijës, nuk do të mund ta njihnit kurrë atë. Një pjesë e madhe e jetës së fëmijës do të mbahej e fshehur ndaj prindërve, duke mos i lënë mundësinë prindit të njohë një pjesë të rëndësishme të fëmijës, sepse orientimi seksual apo identiteti gjinor nuk janë thjeshtë një fazë kalimtare.

Duhet të kemi parasysh se kur dikush arrin t’ia shprehë prindit të vet që është gej, lesbike, biseksual apo transgjinor në fakt nuk po kalon thjeshtë një fazë. Fëmija është menduar gjatë dhe me mundim ka arritur të kuptojë dhe të njohë orientimin e vet seksual apo identitetin gjinor. Prandaj nëse prindi ka dyshime, “A është e sigurt?” përgjigja do të jetë pothuajse gjithnjë “po”. T’i thuash prindit që je gej, lesbike, biseksual apo transgjinor përfshin mposhtjen e shumë stereotipeve dhe ndërmarrjen e një rreziku të madh për këdo që hedh këtë hap lehtësisht ose para kohe. Kjo vlen për tu theksuar jo vetëm në marrëdhënie me prindin por me këdo tjetër me të cilin fëmija vendos të ndajë këtë fakt.

Fakti që fëmija del hapur tek prindrit në lidhje me orientimin seksual apo identitetin gjinor, është shenjë e nevojës së tij për mbështetje dhe mirëkuptim. Kjo gjë tregon një dëshirë të fortë të fëmijës për një marrëdhënie të hapur dhe të ndershme me prindin, një marrëdhënie në të cilën prindi mund dhe duhet ta dojë fëmijën për çka ai ose ajo është, dhe jo për atë çka një prind do të dëshironte që ai apo ajo të ishte.

Përse fëmija nuk u ka treguar më përpara prindërve?

Një vështirësi e fëmijës e cila duhet kuptuar mund të jetë perceptimi për orientimin e vet seksual apo identitetin gjinor, për të cilin fëmija mund të ketë menduar për muaj ose vite, por ka vendosur të tregojë vetëm tani. Është e lehtë të keqinterpretohet si mungesë besimi ose dashurie. Mund të jetë e dhimbshme për një prind të kuptojë se nuk e ka njohur fëmijën e tij aq mirë sa kishte menduar dhe se ka qenë jashtë nga një pjesë e rëndësishme e jetës së fëmijës. Deri diku kjo ndodh në të gjitha marrëdhëniet prindër-fëmijë, edhe në raste kur fëmija është heteroseksual. Ndodh një ndarje e natyrshme ndërmjet prindit dhe fëmijës gjatë moshës së adoleshencës.

Personat homoseksualë apo transgjinorë mund të mbajnë distancë nga prindërit e tyre për sa më gjatë të jetë e mundur, pra jovetëm gjatë doleshencës, pasi iu është dashur shumë kohë për të kuptuar sesi ndjeheshin me veten. Me fjalë të tjera, të rinjtë gej, lesbike dhe biseksualë apo transgjinor shpesh e kuptojnë që në moshë të re që ndihen “ndryshe”, por mund t’iu duhen vite para se t’iu japin një emër këtyre ndjenjave. Gjithashtu është me rëndësi të përmendet se shumica e fëmijëve apo të rinjve LGBTI+ që vendosin të dalin hapur tek prindërit e tyre kanë vuajtur në fshehtësi frikën e mospranimit apo refuzimit nga prindi dhe pjestarë të tjerë të familjes.

Duke qenë se jetojnë në një shoqëri që paragjykon ose është homofobike, atyre iu duhet kohë që të arrijnë të ndërjegjësohen dhe të pranojnë seksualitetin e tyre. Personat gej ndonjëherë kanë edhe një urrejtje të brendshme ose pasiguri për orientimin e tyre seksual apo identitetin gjinor. Shumëkujt i duhet kohë për ta menduar dhe për të vendosur që t'iu tregojnë prindërve.

Pse fëmija im është gej?

Prindërit shpesh e bëjnë këtë pyetje për një sërë arsyesh: ata mund të jenë të mërzitur për humbjen e imazhit të krijuar për fëmijën e tyre; ata ndjehen sikur kanë vepruar gabim diku; mendojnë se dikush “e bëri” fëmijën e tyre homoseksual; ose mendojnë që ka një arsye biologjike të homoseksualitetit.

Disa prindër tronditen dhe e mohojnë faktin që fëmija i tyre është homoseksual. Mund të mendojnë se fëmijën e tyre e kanë bërë homoseksual të tjerë. Koncepti se homoseksualët rekrutojnë është terësisht i gabuar. **Askush nuk mund të bëjë askënd gej, lesbike, biseksual apo transgjinor.** Fëmija duhet ta ketë ditur se ishte i tillë për një kohë të gjatë. Asnjë person apo grup njerëzish nuk “e konvertoi” fëmijën.

Pse prindërit e kanë të vështirë të përshtaten me seksualitetin e fëmijës?

Frika që çdo prind mund të ndjejë është produkt i kulturës sonë paragjykuese. Homofobia është shumë e përhapur në shoqërinë ku jetojmë. Prandaj dhe nuk është e lehtë të çrrënjaset lehtësisht nga ndërgjegjja jonë.

Për sa kohë që homofobia ekziston, çdo person gej dhe familjar i personave gej, lesbike, biseksual apo transgjinor do të ketë frikë dhe shqetësime shumë reale dhe të logjikshme.

Për çdo prind do të ishte shumë ndihmuese të përqendroheshin tek ajo çka fëmija ka nevojë më shumë në atë moment të caktuar, pra mirëkuptim dhe dashuri.

A duhet prindi të këshillohet me një psikolog ose psikiatër?

Asnjë prind nuk duhet të këshillohet me një terapist me shpresën se do të ndryshojë orientimin seksual apo identitetin gjinor të fëmijës. Orientimi seksual apo identiteti gjinor nuk është një sëmundje e cila duhet “kërruar”, por një ekzistencë normale.

Por ka situata kur mund të jetë e dobishme që prindi të konsultohet me persona të cilët kanë përvojë në çështjet familjare, orientimin seksual apo identitetin gjinor.

Theksojmë edhe një herë, që personat gej shpeshherë kanë probleme të pranojnë veten dhe identitetin e tyre seksual. Në kushte të tilla refuzimi edhe nga prindi apo familja mund të jetë një gjëndje e rrezikshme emocionale.

4.3. Përmbledhje e problemeve të shëndetit mendor tek personat LGBTI+³³

Pra siç u përmend përgjatë këtijudhëzuesi, stigma ndaj personave LGBTI+, diskriminimi dhe paragjykimet mund të marrë forma të ndryshme si: shaka kundër personave LGBTI+; ndjenja pasigurie; humbjen e punës; dhunën fizike kundër LGBTI+; braktisjen nga familja; marrëdhënie që nuk pranohen; dhimbjen apo humbjen e partnerit që nuk kuptohet nga të tjerët; bullizëm homofobik në shkollë; izolim në zonat rurale; pasiguri fizike etj. Këto stresorë mund të çojnë në probleme të shëndetit mendor për personat LGBTI+:

Duke qenë pjesë e një grupi minoritar, personat LGBTI+ përjetojnë stres i cili sjell³⁴:

- Nivele të rritura të vetvrasjeve dhe vetëdëmtim tek personat LGBTI+.
- Rrezik të lartë për të përjetuar stres psikologjik krahasuar me personat jo LGBTI+
- Rrezik më të lartë për depresion, çrregullime të ankthit dhe përdorimit të substancave
- Nivele më të larta të konsumimit të alkoolit krahasuar me moshatarët heteroseksualë

Mungesa e suportit social në momentin e daljes hapur, rrit rrezikun për sjellje suicidale tek personat LGBTI+.

Nga ana tjetër është parë që personat LGBTI+ që kanë mbështetjen e familjes, miqve dhe kolegëve në vendin e punës, si dhe ata që janë pjesë e grupeve komunitare dhe organizatave LGBTI+, tregojnë më shumë reziliencë..

4.4. Adresimi i sfidave të përmendura nga profesionistët

Guidë për një praktikë më të mirë me personat LGBTI+³⁵

Ji i ndërgjegjshëm për problemet e shëndetit mendor të personave LGBTI+ dhe stresorët e veçantë në lidhje me të qenit gej.

Krijimi i një mjedisi mbështetës

³³ Guidelines for Good Practice with Lesbian, Gay and Bisexual Clients. Consulted the 9 October in [file:///C:/Users/stahsimi/Desktop/psi_guidelines_for_good_practice_ëith_lgb_clients_\(final\)_1.pdf](file:///C:/Users/stahsimi/Desktop/psi_guidelines_for_good_practice_ëith_lgb_clients_(final)_1.pdf)

³⁴ Guidelines for Good Practice with Lesbian, Gay and Bisexual Clients. Consulted the 9 October in [file:///C:/Users/stahsimi/Desktop/psi_guidelines_for_good_practice_with_lgb_clients_\(final\)_1.pdf](file:///C:/Users/stahsimi/Desktop/psi_guidelines_for_good_practice_with_lgb_clients_(final)_1.pdf)

³⁵ Guidelines for Good Practice with Lesbian, Gay and Bisexual Clients. Consulted the 9 October in [file:///C:/Users/stahsimi/Desktop/psi_guidelines_for_good_practice_ëith_lgb_clients_\(final\)_1.pdf](file:///C:/Users/stahsimi/Desktop/psi_guidelines_for_good_practice_ëith_lgb_clients_(final)_1.pdf)

Pavarësisht nëse ju jeni në dijeni ose jo, klientët tuaj mund të jenë LGBTI+. Më poshtë renditen disa këshilla të përgjithshme për të siguruar një mjedis të hapur dhe mbështetës për ta.

Kini parasysh se klientët tuaj mund të jenë LGBTI+

Mos e merr për të mirëqenë se çdo fëmijë është heteroseksual. Edhe nëse ju e mendoni se nuk keni fëmijë apo të rinj LGBTI+ në vendin ku punoni, me siguri që keni. Shumë fëmijë dhe adoleshentë LGBTI+ nuk e shprehin orientimin seksual ose identitetin gjinor nga frika se mos nuk pranohen nga shoqëria ose profesionistët.

Personat që vijnë për të kërkuar shërbim mund ta kenë identifikuar veten si LGBTI+ ose të kenë një historik marrëdhëniesh me anëtarë të të njëjtit seks. Ata mund të kenë dalë hapur ose jo. Prindërit e fëmijëve LGBTI+ gjithashtu mund të kërkojnë shërbim

Jini të ndërgjegjshëm për besimet dhe qëndrimet tuaja të cilat mund të ndikojnë detyrimet tuaja profesionale ndaj fëmijëve dhe të rinjve LGBTI+

Jini të ndërgjegjshëm për besimet, paragjykimet dhe mungesën e njohurive rreth çështjeve të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Pavarësisht besimeve tuaja personale, ju keni detyrimin profesional të kujdeseni, informoni, mbështesni dhe mbronni të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht orientimit të tyre seksual ose identitetit gjinor. Ky është një detyrim ligjor dhe profesional për ju.

Jini të kujdesshëm për gjuhën që përdorni

Mos përdorni asnjëherë një gjuhë diskriminuese dhe përdorni sa më pak që të jetë e nevojshme referencat gjinore. Mësoni dallimin mes orientimit seksual dhe identitetit gjinor dhe përdorini termat gej, lezbike, biseksual dhe transgjinor sa herë e mendoni të përshtatshme.

Mos u bazoni në stereotipe dhe mos veproni bazuar në përgjithësime

Mos mendoni se personat LGBTI+ janë të dallueshëm bazuar në karakteristika të jashtme ose në sjellje. Kini parasysh që personat e komunitetit LGBT mund të dallojnë nga njëri tjetri dhe të kenë nevoja të ndryshme si çdonjëri nga ne.

Një ndër pyetjet që shpesh bëhet nga profesionistët është ‘‘a duhet pyetur personi drejtpërdrejt për orientimin seksual dhe identitetin gjinorë?’’. Përgjigja është, jo. Ne nuk mund të pyesim dhe as të supozojmë orientimin seksual dhe identitetin gjinorë të dikujt, pa na e thënë më përpara vetë personi në mënyrë eksplicite. Nga ana tjetër, ka shumë mënyra sesi ju mund të tregoni që jeni një person i hapur ndaj orientimeve seksuale dhe identiteteve gjinore të ndryshme: mund të mbani një fletpalosje apo një poster në zyrë në një vend të dukshëm ku flitet për orientimin seksual dhe identitetin gjinorë, mund të flisni pro diversitetit dhe të drejtave të njeriut në aktivitetet e ndryshme nëpër shkolla, qendra komunitare apo ambiente të tjera duke u identifikuar nga persona të komunitetit LGBTI+ si një profesionist të cilit mund t’i drejtohen etj.

Përgatituni për reagimin nëse një fëmijë ju shprehet se është LGBTI+

Përdoreni hapjen ndaj jush si një mundësi për të treguar mbështetje. Tregohuni i gatshëm për të pasur një diskutim të gjatë dhe për të kuptuar dhe shprehur ndjenjat e tij/saj. Qëllimi i punës me fëmijët dhe adoleshentët LGBTI+ është që ata të ndihen të hapur dhe të sigurtë në marrëdhënien që po ngrihet. Mbështetini në vendimet se ndaj kujt, kur dhe si të dalë hapur, duke qenë të sigurtë dhe duke ruajtur konfidencialitetin. Nëse nuk keni njohuri të mjaftueshme mbi çështjet LGBTI+, mos keni frikë ta pranoni, por dhe të jeni të hapur të mësoni më shumë rreth tyre. Asnjëherë mos ofroni informacion mbi orientimin seksual ose identitetin gjinor të një fëmije apo adoleshenti pa miratimin e tij paraprak!

- Përgjigju në mënyrë mbështetëse, kur personat që po marrin shërbimin ju tregojnë se janë LGBTI+.

Dalja hapur është një moment i rëndësishëm në jetën e personave LGBTI+ dhe një moment rreziku për probleme të shëndetit mendor, vecanërisht për fëmijë/të rinj LGBTI+. Disa mënyra sesi mund t’i pyesësh janë:

- A e di njeri që je LGBTI+?
- A ke dalë hapur përpara ndonjë pjestari të familjes?
- Si kanë shkuar gjërat për ty që kur dole hapur?
- Kush/Çfarë të ka ndihmuar kur ke dalë hapur?
- A njeh persona LGBTI+ me të cilët mund të flasësh? A janë mbështetës?
- A ke patur ndonjë përvojë negative që kur ke dalë hapur?

Trajtojini fëmijët dhe të rinjtë LGBTI+ me të njëjtat pritshmëri si të gjithë fëmijët dhe adoleshentët e tjerë të të njëjtës moshë

Mos paragjykoni se problemet e fëmijëve dhe të rinjve LGBTI+ lidhen vetëm me orientimin e tyre seksual ose identitetin gjinor. Nga ana tjetër, tregohuni të vëmendshëm ndaj vështirësive ose rreziqeve të shtuara që ata mund të përballen për shkak të paragjykimeve shoqërore dhe izolimit social. Sa herë këshilloni një fëmijë LGBTI+ mbi marrëdhëniet e tij/saj intime ose romantike, pyesni veten nëse do i drejtonit të njëjtat këshilla një bashkëmoshatarit ose bashkëmoshatarëve heteroseksuale. Ndërkohë, kini parasysh se të gjithë adoleshentët kanë nevojë të mbështeten me informacion të përshtatshëm mbi seksualitetin dhe shëndetin seksual.

Familjarizohuni me shërbimet e mundshme për mbështetje

Përgatitni një listë me shërbimet e nevojshme ndihmëse ose mbështetëse. Disa prej tyre i gjeni dhe në fund të këtij manuali, por kjo listë nuk është ezauruese. Në zonën tuaj mund të ketë dhe shërbime të tjera tek të cilat ju mund të kenë besim për mbështetjen e të rinjve LGBTI+.

Çfarë duhet të kenë tjetër parasysh punonjësit kur punojnë me fëmijë dhe të rinj LGBTI+ dhe në veçanti psikologët:

- Fëmijë dhe të rinj LGBTI+ mund të kenë patur në të kaluarën përvoja negative me ofruesit e shërbimeve.
- Kur fëmijë dhe adoleshentë LGBTI+ shkojnë te psikologu për arsye që nuk lidhen me orientimin e tyre, ata përballen me disa stresorë që ndikojnë në shëndetin e tyre mendor:
 - Mund t'iu bëhen pyetje rreth orientimit seksual.*
 - Mund të refuzohen ose të pranohen me vështirësi për shkak të orientimit.*
 - Kanë frikë të dalin hapur ose nuk duan të dalin hapur.*
 - Nuk pranohen apo mbështeten nga miqtë dhe familja*
 - Përjetojnë bullizëm apo ngacmime në shkollë, vende pune apo ambiente të tjera*
 - Ekspozohen me mesazhe negative, stigmë, paragjykime dhe stereotipe dhe me pasojat e mundshme që këto kanë te koncepti për veten, vetë identiteti dhe vetëvlerësimi*
 - Përjetojnë dhunë në marrëdhënie*

□ *Përjetojnë izolim dhe vetmi (nuk kanë kontakt me komunitetin LGBTI+, jetojnë në zona rurale ose nuk kanë marrëdhënie afatgjata)*

□ *Jetojnë një jetë të fshehtë apo të dyfishtë*

□ *Mund të jenë ekspozuar ndaj shërbimeve joafirmuese të të dëmshme për ta.*

Studimet tregojnë se të dalët hapur dhe pranimi i orientimit seksual LGBTI+ lidhet fort me një përshtatje të mirë psikologjike (sa më pozitiv identiteti LGBTI+, aq më i lartë vetëvlerësimi dhe aq më i mirë shëndeti mendor).

Përpiqu ta shmangësh pohimin se fëmijët/të rinjtë thjesht po kalojnë një fazë dhe janë shumë të vegjël për të kuptuar nëse janë LGBTI+ apo jo. Në praktikën tonë me personat LGBTI+, është vënë re se shumë profesionistë, pavarësisht ekspozimit të tyre me anëtarë të komunitetit LGBTI+ ose jo, ende e kanë të vështirë të kuptojnë dhe pranojnë se një fëmijë mund të ndërgjegjësohet shpejt për orientimin e tij seksual ose se të qenit LGBTI+ nuk lidhet me përvoja të hershme abuzimi (që i trajtuam më sipër si mite), dhe provojnë të “korrigjojnë”, ndërhyjnë, apo ndëshkojnë të qenit LGBTI+, duke sjellë pasoja negative në jetët e fëmijëve dhe shëndetin e tyre mendor.

Ofro informacion që do t’i mbështesë dhe qetësojë fëmijët/të rinjtë dhe merr në konsideratë që t’i referosh ata në organizata LGBTI+ për të marrë mbështetje. (shiko kontaktet në fund të udhëzuesit).

- Psikologët dhe punonjësit social duhet të sigurojnë që këshillimi, psikoterapia dhe mbështetja sociale që ofrohet është e qendërsuar te klienti dhe gej-pranuese (afirmuese).

Terapia gej-pranuese (afirmuese) bazohet në disa parime:

□ *Tërheqjet seksuale, sjelljet dhe orientimet mes të njëjtit seks janë variacione normale dhe pozitive të seksualitetit njerëzor dhe nuk janë tregues i çrregullimeve mendore apo të zhvillimit.*

□ *Homoseksualiteti dhe biseksualiteti janë stigmatizuar historikisht, dhe kjo stigmë e zgjatuar në kohë mund të ketë një sërë pasojash negative në ciklin e jetës të personave LGBTI+.*

- *Personat LGBTI+ mund të kenë jetë të kënaqshme dhe të formojnë marrëdhënie stabël dhe të angazhuara dhe familje, të ngjashme me ato të heteroseksualëve.*
- *Orientimi ndaj të njëjtit seks nuk lidhet me trauma apo familje origjine jofunksionale.*
- *Orientimi seksual nuk mund të ndryshohet dhe e ashtuquajtura terapi konversionale nuk funksionon dhe mund të dëmtojë shëndetin mendor të klientit që i nënshtrohet.*
- *Ka shumë të dhëna nga hulumtimet ndërkombëtare që mbështesin terapinë gej/pranuese (afirmuese) me të gjithë klientë/et LGBTI+, duke përfshirë ata që po eksplorojnë dhe/ose pyesin mbi orientimin e tyre seksual, si dhe atyre që shprehin pakënaqësi nga orientimi i tyre seksual.*

➤ Trego se praktika jote është pranuese për personat LGBTI+.

Trajtimi i pyetjeve të cilave nuk ua dini përgjigjen

Ju mund të mos e dini përgjigjen e të gjitha pyetjeve. Në këtë rast, ju mund të ndiheni rehat duke thënë “unë nuk e di përgjigjen e kësaj pyetjeje por do kërkoj informacion dhe do të informoj.” Më pas ju mund të merrni kontaktet e duhura për t’iu përgjigjur pyetjes (mund të kontaktoni me organizatat LGBTI+). Ju mund të inkurajoni fëmijët apo adoleshentët LGBTI+ që të kryejnë kërkimin e tyre dhe të mbahet një sesion shtesë për të folur mbi të dhënat e arritura. Është e rëndësishme të njihen të dhënat në mënyrë të detajuar.

4.5. Studime rastesh dhe çështje për reflektim

Bazuar edhe në diskutimet dhe informacionin e dhënë më sipër, ju mund të merrni pak minuta dhe të reflektoni mbi situatat e mëposhtme:

Skenari 1 (dalja hapur)

Një nxënës ju tregon që është gej. Ai thotë se shumë nga miqtë e tij e dijnë dhe se ata janë shumë mbështetës.

Ai ju thotë që nuk i ka treguar akoma prindërve të tij por që do të dëshironte shumë ta bënte diçka të tillë. Ju shpreh dëshirën për të qenë i hapur dhe sinqertë rreth orientimit të tij seksual me të gjithë por është i pasigurt dhe i frikësuar nga reagimi që mund të kenë prindërit e tij, mësuesit dhe personat e tjerë.

- Si do ndiheshit ju në këtë situatë?
- Çfarë do të bënit?
- Çfarë mendoni që duhet të bëjë kolektivi dhe shkolla juaj?

Skenari 2 (dalja hapur)

Një pasdite ndërkohë që jeni duke mbyllur klasën një nxënëse vjen dhe ju thotë që ka vendosur të shkojë në shtëpi dhe t’u tregojë prindërve të saj që ajo është lezbike. Ju i njihni prindërit e saj dhe mendoni se ata do të reagonin negativisht në lidhje me këtë situatë.

Ju tregon se keni qenë të rëndësishëm në daljen e saj hapur, pasi jeni treguar gjithnjë pozitiv dhe mbështetës në lidhje me personat LGBTI+.

- Si do ndiheshit ju në këtë situatë?
- Çfarë do të bënit?
- Çfarë mendoni që duhet të bëjë kolektivi dhe shkolla juaj?

Skenari 3

Ju dëgjoni një nga kolegët që përdor gjuhë homofobike. Keni shprehur shqetësimin tuaj duke i thënë dhe herë të tjera të mos përdorë këtë lloj gjuhe por kolegu ju është përgjigjur, duke thënë se ju po tregoheni “shumë i ndjeshëm” dhe “politikisht korrekt”.

- Si do të ndiheshit ju në këtë situatë?
- Çfarë do të bënit?
- Çfarë masash mendoni se duhet të marrë institucioni?

V. VLERAT, BESIMET STEROTIPET DHE PARAGJYKIMET E PROFESIONISTËVE QË MUND TË NDËRHYJNË NË PUNËN E TYRE ME FËMIJËT LGBT

Në Shqipëri stereotipat gjinorë dhe praktikrat tradicionale nuk i pranojnë pamjet dhe sjelljet që nuk përputhen me gjininë³⁶. Madje edhe vetë brenda modelit gjinor binar, stereotipat janë

³⁶ oni dhe Hazizaj (2016a) Shërbimet në komunitet dhe komuniteti LGBT në Shqipëri: Qëndrimet e administratës publike ndaj personave LGBTI përdorues të shërbimeve: studim në gjashtë bashki. Tirana: Botimet e Ambasadës PINK, gjendet në:

tejet të ngurtë dhe imponojnë sjellje rreptësisht të përcaktuara mashkullore ose femërore, dhe sjellja e njerëzve duhet t'i përmbahet njëres ose tjetres kategori gjinore përkatëse. Devijimet midis dy skajeve të sistemit gjinor binar dekurajohen me forcë dhe quhen të dënueshme nga pikëpamja morale. Si një shoqëri kryesisht patriarkale, shqiptarët tregojnë mosmiratim të fortë shoqëror për çdo formë seksualiteti që del jashtë normativës heteroseksuale. Vrojtimit studimore për homofobinë kanë treguar se shqiptarët kanë perceptime shumë negative për personat LGBTI+. Ndjenjat homofobike shumëfishohen nga mungesa e njohurive dhe e ndërveprimit me personat LGBTI, të cilët janë të padukshëm për të tjerët, një fakt që pohohet nga 92% e të anketuarve. Mendimi i publikut të gjerë për dhunën e ushtruar mbi personat LGBTI nuk përputhet me realitetin³⁷. Gjendja e vështirë familjare në të cilën jetojnë shumica e personave LGBTI pothuaj nuk njihet fare nga pjesa tjetër e komunitetit. Prindërit e personave LGBTI zakonisht mundohen ta mbajnë këtë fakt të fshehur nga sytë e të tjerëve, “për të mos humbur nderin”, dhe i detyrojnë fëmijët e tyre ta shtypin homoseksualitetin³⁸. Anëtarët e familjes ndalojnë komunikimin me persona LGBTI+ ose i dëbojnë nga shtëpia.³⁹

Qasja në shërbimet shëndetësore psikologjike dhe mendore është problem i konsiderueshëm, duke pasur parasysh trysnitë e mëdha që shkaktohen nga diskriminimi, stigma, përjashtimi shoqëror dhe homofobia e rrënjosur thellë. Profesionistët vetë janë mbartës të vlerave dhe stereotipeve të mendësinë së shoqërisë në të cilën janë rritur. Ndonëse nuk është faktor i rëndësishëm, feja përpiket të ndikojë në të kuptuarit dhe perceptimin e shoqërisë për personat LGBTI si deviantë. Në bazë të një studimi që Aleanca LGBT ka realizuar në vitin 2015 në gjatë rrethe të vendit (në sajë të projektit “Zvogëlimi i Dhunës ndaj Grave me fokus në komunitetin LBT në Shqipëri”), që eksploron këndvështrimet e ofruesve të shërbimeve dhe vetë individëve LBT, u tregua se individët LBT në vend përballen me paragjykime, diskriminim, abuzim verbal dhe fizik në shërbimet shëndetësore dhe arsimore, pavarësisht nga qyteti apo komuna. Këto përbëjnë pengesa serioze për individët LBT, të cilët janë

<http://www.PINKembassy.al/sites/default/les/uploade/SHE%CC%88RBIMET%20VENDORE%20DHE%20KOMUNITETI%20LGBT%20NE%20SHQIPERI%202016.pdf>, aksesuar më 4.9.2016.

³⁷ Anketa e NDI: Vetëm 36% e publikut të gjerë mendojnë se personat LGBTI përballen me ndonjë formë të dhunës psikologjike, kur në fakt 76% e personave LGBT raportojnë se kanë përjetuar dhunë psikologjike, si shaka mizore, komente poshtëruese, fyerje dhe kërcënime për dhunë zike, ku familjarët dhe shoqëria janë autorët kryesorë të kësaj dhune.

³⁸ Anketa e NDI: Për 60% të publikut të gjerë, personat LGBTI nuk duhet t'i shfaqin OSIGJ të tyre. Kjo shifër është edhe më e lartë tek familjet dhe shoqëria, sepse 76% e tyre mendojnë se personat LGBTI duhet ta fshehin OSIGJ-në e tyre nga të tjerët, që të mos turpërojnë veten, familjet dhe shoqërinë.

³⁹ Anketa e NDI: Vetëm 6% e familjeve do ta përkrainin një anëtar LGBTI, ndërsa të tjerat do të përpiqeshin ta fshihnin nga të tjerët, do të ndalonin komunikimin me ta, dhe do t'i dëbonin nga shtëpia.

abuzuar apo në rrezik për abuzim për shkak të orientimit të tyre seksual ose identitetit gjinor, dhe kanë nevojë për mbështetje nga ofruesit e shërbimeve.

Profesionistët në fushën e mbrojtjes së fëmijëve (si psikologë, punonjës social etj) që gjatë punës së tyre mund të jenë në kontakt me fëmijë apo të rinj LGBTI+, mund të mbartin stereotipe që i shfaqin në këtë mënyrë:


- tregojnë se në qytetet kur jetojnë nuk ka fëmijë apo të rinj LGBTI+, Tregojnë se shfaqje të tilla ndodhin vetëm në qytete të mëdha ose gjatë adoleshencës, duke mohuar ekzistencën e tyre ose duke nënkuptuar se homoseksualiteti është një “zgjedhje” momentale.
- Disa raportojnë se kjo temë nuk ka lidhje me ta, sepse ata punojnë me fëmijë LGBTI+ deri në 15 vjeç,
- Disa raportojnë se fëmijë apo të rinjtë LGBTI+, identifikohen lehtë që janë pjesë e komunitetit nga pamja apo sjellja e tyre.
- Disa raportojnë se të jesh gej është devijim apo sëmundje mendore.

Siç thamë më sipër, fëmijët dhe të rinjtë LGBTI+ duke qenë subjekt i dhunës dhe diskriminimit vuajnë si pasojë edhe probleme të shëndetit mendor, dhe kanë shumë nevojë për pranimin dhe ndihmën e punonjësve që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Vlerat, besimet dhe qëndrimet që një ofrues shërbimesh mbart, mund të kenë ndikim të rëndësishëm në shëndetin mendor dhe sigurinë personale të fëmijëve dhe të rinjve LGBTI+. Është e rëndësishme që profesionistët që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, duke qenë në kontakt të drejtpërdrejt me ta të kenë një të kuptuar të qëndrimeve dhe vlerave që ata duhet të mbartin dhe tolerancë ndaj diversitetit. Së pari, ata duhet t’u shërbejnë fëmijëve në mënyrë etike dhe të jenë të aftë të vlerësojnë dinjitetin dhe vlerën e çdo klienti, pavarësisht orientimit të tij seksual. E përsërisim edhe një herë se diskriminimi kundër personave LGBTI+ lidhet në një shkallë të lartë me çrregullimet psikologjike, përdorimin e substancave dhe vetëvrasjen. Prandaj nëse një punonjës në fushën e mbrojtjes së fëmijëve mendon se të jesh LGBTI+ është sëmundje, devijancë, zgjedhje personale, rezultat i abuzimit në fëmijëri apo se orientimi mund të ndryshohet, ai/ajo NUK ËSHTË GATI të punojë me këtë komunitet. Dhe është më mirë të tërhiqet, të reflektojë dhe të përpiqet të kuptojë sesa të DËMTOJË !

Ndërkohë, në Shqipëri ka një akses të pamjaftueshëm në shërbimet psikologjike dhe ato të shëndetit mendor⁴⁰, duke marrë parasysh presionin e madh të diskriminimit, stigmës, homofobisë së brendësuar me të cilën ndeshen fëmijët dhe të rinjtë LGBTI+. Kjo tregon shumë për qëndrimet negative që mbajnë punonjësit e fushës së shëndetit mendor ndaj fëmijëve dhe të rinjve LGBTI+. Disa prej tyre, për shkak të mungesës së informacionit, mënyrën si janë edukuar dhe rritur, mungesës së ndjeshmërisë kulturore dhe barrierave personale në lidhje me seksualitetin, stigmatizojnë, diskriminojnë dhe dëmtojnë fëmijë dhe të rinj LGBTI+

Fëmijët dhe të rinjtë LGBTI+ që e mbajnë seksualitetin të fshehur janë në rrezik të rritur për stres psikologjik, dhe ndonjëherë nuk kanë akses edhe në ato shërbime apo komunitete LGBTI+ që mund t'i ndihmonin kundër efekteve negative të stigmës. Ata na kanë treguar se duhen të kërkojnë shërbime dhe e fshehin orientimin e tyre, nga frika ose sepse kanë patur një përvojë të mëparshme negative me ofruesit e shërbimeve : mungesë respekti, thyerje konfidencialiteti ose mohim të dhënies së shërbimit. Në shumë raste për shkak të mungesës së informacionit, ofruesit e shërbimeve u kanë thënë se « kjo është sëmundje apo devijancë, është një fazë që do të kaloj », « se orientimi seksual mund të ndryshohet » dhe të njëjtin informacion e kanë ndarë edhe me prindërit. Edhe pse ndikimi fetar është relativisht i ulët, elementë kulturorë të shoqërisë shqiptare promovojnë idenë se personat LGBTI+ janë devijantë.

VI. MITE DHE FAKTE⁴¹



⁴⁰ <https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/ALBANIA%20FINAL%20REPORT%2018.10.2017.pdf> konsultuar me 9 dhjetor 2019.

⁴¹ <https://www.splcenter.org/fighting-hate/intelligence-report/2011/10-anti-gay-myths-debunked> consulted in 8 december 2019.

<p>MIT #1</p> <p>Burrat gej ngacmojnë fëmijët më shumë sesa burrat heteroseksualë</p>	<p>FAKTE</p> <p>Sipas Shoqatës Amerikane të Psikologëve, nuk ka evidenca që fëmijët ngacmohen më shumë nga personat LGBTI+ ose miqtë apo të njohurit e tyre LGBT. Një profesor në Universitetin e Kalifornisë, që është lider i studimeve mbi paragjykimet kundër minoriteteve seksuale, kreu një studim dhe nuk gjeti të dhëna se burrat molestojnë fëmijët më shumë sesa burrat heteroseksualë. Kjo përforcohet nga një kërkim i Nicholas Groth, pioner në fushën e abuzimit seksual të fëmijëve, që tregoi se kjo nuk është e vërtetë.</p> <p>Instituti i Studimeve dhe Parandalimit të Abuzimit të Fëmijës tregon se 90% e abuzuesve i targetojnë fëmijët në rrethin e tyre të familjes dhe fëmijëve, dhe pjesa më e madhe janë burra të martuar me gra.</p>
<p>MIT #2</p> <p>Prindërit e të njëjtës gjini e dëmtojnë fëmijën.</p>	<p>FAKT</p> <p>Nuk ka studime që kanë treguar se prindërit e të njëjtës gjini krahasuar me ata heteroseksualë e dëmtojnë fëmijën.</p> <p>Sipas Akademisë Amerikane të Pediatriisë në 2013 “një literaturë shkencore gjithmonë e më e madhe tregon se fëmijët që rriten me një ose dy prindër gej, rriten po aq mirë në funksionimin emocional, konjitiv, social dhe seksual sesa fëmijët me prindër heteroseksualë ».</p> <p>Sipas APA, stereotipet negative mbi prindërimin e personave LGBT nuk mbështeten nga të dhëna shkencore. Në një nga studimet më të mëdha botërore të vitit 2014, në Australi, tregohet se fëmijë të rritur nga prindër gej dhe lezbike rriten më të shëndetshëm dhe në familje që kanë kohezion më të fortë se ato heteroseksuale</p>
<p>MIT #3</p> <p>Njerëzit bëhen homoseksualë sepse ata kanë qenë të abuzuar seksualisht kur ishin fëmijë ose për shkak të një</p>	<p>FAKTE</p> <p>Nuk ka baza shkencore që e lidh orientimin seksual ose identitetin me rolin gjinor të modeluar nga prindërit ose abuzimin seksual në fëmijëri..</p> <p>Organizata Botërore mbi Viktimizimin Seksual Mashkullor shkruan se « ekspertët në fushën e seksualitetit njerëzor nuk besojnë se</p>

<p>mangësie të rolit gjinor të modeluar nga prindërit.</p>	<p>përvojat e hershme seksuale luajnë një rol domethënës në adoleshencën e vonë ose orientimin seksual si i rritur » dhe shtojnë se nuk ka gjasa që dikush ta bëjë dikë tjetër gej apo heteroseksual.</p>
<p>MIT #4</p> <p>Asnjë nuk lind gej.</p>	<p>FAKTE</p> <p>Shkencat moderne nuk kanë arritur në përfundim se çfarë e shkakton orientimin seksual, por shumë studime sugjerojnë se vjen si rezultat i ndërveprimit të forcave biologjike dhe mjedisore, dhe jo e një « zgjedhjeje » personale.</p> <p>Shoqata Amerikane e Psikologëve (APA) citon se orientimi seksual « renditet në një kontinuum », dhe njih se pavarësisht shumë studimeve në ndikimet e mundshme gjenetike, hormonale, sociale dhe kulturore në orientimin seksual, shkencëtarët ende duhet të gjejnë shkaqet e orientimit seksual. Pavarësisht kësaj, APA citon se « shumë njerëz përjetojnë pak ose aspak zgjedhje rreth orientimit të tyre seksual.</p>
<p>MIT #5</p> <p>Njerëzit gej mund të zgjedhin që ta lënë homoseksualitetin.</p>	<p>FAKTE</p> <p>Të qenit LGBTI+ nuk është ‘zgjedhje’ ose diçka që të rinjtë mund ta ndryshojnë.</p> <p>Shoqatat kryesore të profesionistëve kanë njohur prej kohësh se orientimi seksual lezbik ose gej është një version normal i seksualitetit njerëzor dhe nuk është më shumë i luhatsëm për ndryshim sesa orientimi heteroseksual. Një person LGBTI+ asnjëherë nuk duhet t’i nënshtrohet terapive ‘riparuese’ me qëllim ndryshimin e orientimit ose identitetit të tij/saj seksual.</p>

VII. SHËRBIMET PER PERSONAT LGBTI+

Më poshtë do të gjeni një listë të organizatave kryesore që ofrojnë shërbime për komunitetin LGBTI+ në Shqipëri:

Emri: *Aleanca kundër diskriminimit LGBTI+*

E-mail: aleanca.al@gmail.com

Faqja e internetit: www.aleancalgbt.org

Tel: *0696484490*

Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve të organizatës:

Aleanca Kundër Diskriminimit të LGBTI+ është një organizatë jo-qeveritare shqiptare që parashikon një shoqëri të lirë, të hapur, dhe të barabartë për të gjithë identitetet seksuale e gjinore njerëzore. Aleanca ka për qëllim krijimin dhe fuqizimin e komunitetit shqiptar LGBTI+, mbrojtjen e të drejtave të tij dhe luftën kundër diskriminimit të bazuar tek orientimi seksual dhe identiteti gjinor. Aleanca nisi aktivitetet e saj në mars të vitit 2009, kur një grup vullnetarësh LGBTI+ filluan punën mbi hartimin e programeve dhe aktiviteteve për komunitetin, dhe u regjistrua si organizatë jo-qeveritare në nëntor 2009. Programet dhe aktivitetet e Aleancës LGBTI+ përfshijnë:

- Fuqizim i komunitetit LGBTI+ në Shqipëri
- Organizim i eventeve sociale të vazhdueshme për komunitetin me synim njohjen mes tyre dhe informimin për çështje LGBTI+ (grupe javore diskutimi, festa javore, shfaqje filmash, pikniqe, skuadër futbollit për vajza etj).
- Ndërlidhje e komunitetit shqiptar LGBTI+ me ato në rajon (p.sh. pjesëmarrje në Gay Pride në Kroaci, informim i vazhdueshëm për zhvillime në rajon).
- Mbështetje për personat LGBTI+ dhe familjarët e tyre që duan të ndajnë problemet me dikë që mund t'i kuptojë dhe ndihmojë.
- Advokaci dhe lobim me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, aktorë qeveritarë, dhe bashkësinë ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI+ në Shqipëri.
- Ndërgjegjësim dhe edukim publik

- Fushata publike informimi nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese (fletushka, postera, broshura) në formë elektronike dhe duke ndaluar njerëzit në rrugë (p.sh. Doktorët e Homofobisë).
- Prezantime dhe leksione në universitete mbi historikun e lëvizjeve për të drejtat e njerëzve LGBTI+, për komunitetin LGBTI+ në Shqipëri etj.
- Pjesëmarrje në emisione televizive dhe radiofonike.
- Botime shkrimesh dhe intervista në median e shkruar
- Advokaci dhe lobim me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, aktorë qeveritarë, dhe bashkësinë ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI+ në Shqipëri.

Emri: ***QENDRA STREHA***

E-mail: **strehalgbt@gmail.com**

Faqja e internetit: **www.strehacenter.org**

Tel (mob): **+355699839189**

Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve të organizatës:

“STREHA” është qendra e parë rezidenciale në Shqipëri që i vjen në ndihmë komunitetit LGBTI+ në rastet e emergjencave në aspektin e strehimit.

Streha nisi aktivitetet e saj si projekt pilot që prej Dhjetor 2014 duke operuar si projekt pilot i përbashkët i dy organizatave në fushën e të drejtave të komunitetit LGBTI+, nga “Aleanca Kundër Diskriminimit të LGBTI+” dhe “ProLGBTI+” (Të Bashkuar Pro Kauzës LGBTI+). Që prej Nëntorit 2015, Qendra Streha u themelua si entitet i pavaruar në kuadër të qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë së konsolidimit të shërbimit për komunitetin LGBTI+ në risk.

Qendra “Streha” është një shërbim tranzitor për të gjithë të rinjtë LGBTI+ 18-25 vjeç që hasin dhunë, diskriminim dhe nevojë për strehim për shkak të orientimit të tyre seksual. Streha ofron shërbim ri-integrimi 24 orë në 7 ditë të javës për të rinjtë LGBTI+ të pastrehë dhe në risk përjashtimi social nëpërmjet 8 personave të stafit. Ajo ka një kapacitet prej 8 shtretërisht dhe synon të ofrojë ndihmë dhe shërbim për të rinjtë LGBTI+ të pastrehë, si dhe punon për ri-integrimin dhe fuqizimin e tyre si pjesë e shoqërisë.

Ndërhyrjet kryesore që realizon streha janë:

- Shërbimi bazë
- Akomodim
- Ushqim
- Asistencë mjekësore
- Asistencë për punësim
- Asistencë për arsim/kurse profesionale
- Këshillim karriere
- Këshillim psikologjik
- Këshillim në grup
- Negocim me familjet
- Aktivitete psiko-edukuese
- Aktivitete socio-kulturore

2. Koordinim terreni

- Koordinim me institucionet për përfshirjen e shërbimit në mekanizmin ekzistues të referimit të dhunës
- Koordinim me komunitetin
- Ndjekje e rasteve në distancë (komunitet)

Që prej tetorit 2017 Streha ka filluar të punojë për ndjekjen e rasteve në distancë. Ngritja e udhëzuesve dhe protokollit të ndjekjes janë hapat e para për të vijuar këtë shërbim.

https://www.undp.org/content/dam/albania/img/Publications/Intersex%20Research%20Study%20UNDP%202017_AL.pdf

ⁱⁱ Përshtatur nga: *Caring for LGBTIQ Children and Youth - A guide for child welfare providers, Human Rights Campaign*, http://hrc-assets.s3-website-us-east-1.amazonaws.com/files/assets/resources/HRC_Caring_For_LGBTIQ_Children_Youth.pdf

ⁱⁱⁱ

<https://www.parlament.al/Files/Kerkese/20190315144121RAPORTI%20VJETOR%202018%20%20KMD.pdf>

